

UDHËZIM
Nr. 3, datë 2.6.2021

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR RUAJTJEN E GJELIT TË EGËR
(*Tetrao Urogallus*), SI NJË NGA LLOJET VEÇANËRISHT TË MBROJTURA, TË
REGJISTRUAR ME STATUS “RUAJTJE TË PAFAVORSHME”, NDODHUR NË
PARKUN KOMBËTAR TË MALIT TË TOMORIT, NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit për ruajtjen e gjelit të egër (*Tetrao Urogallus*), si një nga llojet veçanërisht të mbrojtura, të regjistruar me status “ruajtje të pafavorshme”, ndodhur në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit, Shqipëri, për periudhën 2021–2023, bashkëlidhur këtij Udhëzimi si pjesë integrale e tij.
2. Zbatimi i Planit të Veprimit për ruajtjen e gjelit të egër, të përfshihet dhe të integrohet në politikat, planet e menaxhimit, programet dhe veprimtaritë që lidhen me to, si dhe në vendimmarrjet në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administratat rajonale të zonave të mbrojtura për të zbatuar Planin e Veprimit për ruajtjen e gjelit të egër (*Tetrao Urogallus*).
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

PLANI I VEPRIMIT
PËR RUAJTJEN E GJELIT TË EGËR (*TETRAO UROGALLUS*)
NË PARKUN KOMBËTAR TË MALIT TË TOMORIT, SHQIPËRI

Përmbajtja e lëndës

Hyrje

- 1.1 Përshkrimi i llojit
- 1.2 Statusi aktual i ruajtjes
- 1.3 Korniza rregullative
Konventa dhe direktiva ndërkombëtare.
- 1.4 Legjislacioni kombëtar
- 1.5 Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit
- 1.6 Analiza e kontekstit (korniza territoriale dhe fitoklimatike)
- 1.7 Ekologjia dhe gjendja e popullatës së gjelit të egër në planin teorik të njohjes dhe të të dhënave paraprake të publikuara për parkun e Tomorit
Përshkrimi dhe biologjia e gjelit të egër (*Tetrao Urogallus L.*), si dhe shpërndarja dhe statusi i tij në botë, Evropë dhe Shqipëri
- 1.8 PËRSHKRIMI
- 1.9 AREALI DHE BIOTOPI
- 1.9.1 RIPRODHIMI
- 1.9.2 RITMI I AKTIVITETIT DITOR
- 1.9.3 USHQIMI
- 1.9.4 GJUETIA
- 2 Njohja reale e gjendjes së tanishme e popullatës (popullatave) të gjelit të egër në Parkun e Malit të Tomorit
- 2.1 Sipërfaqja e përhapjes reale të gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit
- 2.2 Kërkime paraprake
- 2.3 Studimi i tipave të pyjeve që hasen në habitatin e gjelit të egër në Parkun e Tomorit, bazë për përcaktimin e dimensioneve të popullatës së tij
- 2.4 Grumbullimi i të dhënave në terren lidhur me dimensionet e popullatës së gjelit të egër në parkun e Tomorit
- 2.5 Metodatat e monitorimit të popullatave të gjelit të egër
- 2.6 Monitorimi në periudhën e riprodhimit
- 2.7 Monitorimi në periudhën dimërore
- 2.8 Monitorimi veror
- 2.9 Praktika e monitorimit
- 2.9.1 Rezultatet e rilevimeve
- 2.9.2 Rilevime (numërime) pranverore
- 2.9.3 Rilevime verore
3. Gjendja e popullatës së gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit
- 3.1 Efektiviteti i vlerësuar për tërë parkun
- 3.2 Fiksimi në hartë dhe përshkrimi i vendeve të këngës (arenave) të determinuara bazë për përsëritjen e numërimeve në vitet e ardhshme
- 3.3 Kërcënime ndaj popullatës së gjelit të egër në masivin e malit të Tomorit
4. Identifikimi i vendimmarrësve dhe i aktorëve të tjerë që janë përfshirë direkt në menaxhimin e habitatit/species dhe analiza SWOT
- 4.1 Autoritetet qendrore
- 4.2 Autoritetet lokale
- 4.3 Analiza SWOT
5. Përcaktimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifike për ruajtjen e habitateve/specieve në periudha afatshkurtra, të mesme dhe të gjata

6. Plani i Veprimeve për ruajtjen dhe rikualifikimin e habitatit dhe të popullatës (popullatave) së gjelit të egër në parkun e Tomorit

6.1 Përmirësimin e politikave për ruajtjen e species *Tetrao Urogallus* dhe të planit të menaxhimit

7. Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në habitatet e *Tetrao Urogallus*

8. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

8.1 Menaxhimi dhe monitorimi i llojit *Tetrao Urogallus* dhe ruajtja e habitatit

8.2 Ndërhyrje lidhur me përmirësimin e biotopit

8.3 Masa lidhur me menaxhimin e shqetësimeve

8.4 Masa lidhur me gjuetinë dhe problematiken e lindur prej saj

8.4.1 Masa për përmirësimin e habitatit

8.4.2 Masat që kanë për qëllim të kufizojnë shqetësimet

8.4.3 Masa për kufizimin e mortalitetit aksidental dhe atij artificial

8.4.4 Detaje të tjera të punës për thellimin e njohjes së gjelit të egër në PK të Malit të Tomorit

8.4.5 Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese

9. Informacione dhe masa sensibilizuese për aktorët dhe për popullsinë lokale në drejtim të thellimit të njohjes së gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

10. Vlerësim i impaktit të Planit të Veprimit për mbrojtjen dhe menaxhimin korrekt të habitatit/species

10.1 Problemet e pritshme gjatë implementimit

10.2 Impakti njerëzor

11. Identifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare, të cilat do të përfshihen në projekt nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet publike dhe private

12. Monitorimi i Planit të Veprimit për kontrollin e efektivitetit të veprimeve

13. Lista e indikatorëve për monitorimin

Lista e figurave

Figura 1. Harta e habitateve në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

Figura 2. Mashkulli i *Western Capercaillie* (*Tetrao Urogallus*)

Figura 3. Femra (*Tetrao Urogallus*)

Figura 4. Shpërndarja e *Tetrao Urogallus*

Figura 5. *Western Capercaillie* mashkulli dhe femra

Figura 6. Habitatit i *Tetrao Urogallus*

Figura 7. Mashkulli dhe femra në paradën e dashurisë

Figura 8. Vezët e *Tetrao Urogallus*

Figura 9. Jashtëqitjet e *Tetrao Urogallus*

Figura 10. Harta e shtrirjes së territorit ku është dëgjuar gjeli i egër

Figura 11. Model, kullë vrojtimi

Figura 12. Projektimi i pyjeve, kërkesat mjedisore dhe rekomandimet e përgjithshme për implementimin e masave silvikulturale për ruajtjen e *Tetrao Urogallus*

Lista e tabelave

Tabela 1. Kategorizimi i territorit

Tabela 2. Rilevimet pranverore

Tabela 3. Të dhëna mbi çuarjet

Tabela 4. Analiza SWOT

Tabela 5. Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese

Hyrje

1.1 Përshkrimi i llojit

Shpërndarja gjeografike e shumë specieve të rendit Galliformes ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, për shkak të aktiviteteve njerëzore (p.sh. gjuetia e tepruar, sëmundjet, zjarret, shpyllëzimet) dhe kjo gjë shpesh ka çuar në boshllëqe jonatyrore të shpërndarjes së tyre. Duke konsideruar kompleksitetin e kërkesave ekologjike dhe ndërveprimet sociale të Galliformeve, është e rëndësishme që çdo boshllëk në shpërndarjen e tyre, i shkaktuar nga njeriu, duhet të vlerësohet plotësisht për potencialin që ofron për ripopullim. Shumë specie të rendit Galliformes kanë kërkesa specifike ndaj habitatit: disa prej tyre nuk janë elastike për të toleruar modifikime të tepruara të habitateve ku jetojnë. Specie të tjera mund të përshtaten ndaj etapave suksesive të caktuara. Në këto raste, megjithëse habitatit mund të duket fillimisht i përshtatshëm, nevojitet një studim i detajuar i strukturës dhe përbërjes së tij, për të garantuar përmbushjen e nevojave të species për periudha afatgjata.

Kohët e fundit ripopullimet po përdoren gjerësisht si një instrument i menaxhimit të faunës së egër, për të ripërtëritur në habitate të përshtatshme, popullata kafshësh dhe shpendësh në rrezik zhdukjeje apo të pakësuar. Një pjesë e mirë e këtyre popullatave u përkasin specieve të rendit Galliformes. Galliformet sigurojnë kandidatët e përshtatshëm për ripopullimet, me qëllim ruajtjen e tyre dhe kjo, për disa arsye:

Së pari, për shkak të lëvizjes së tyre të pakët, ekziston rrezik i ulët për migrim apo lëvizje jashtë territorit në krahasim me speciet e tjera të shpendëve.

Së dyti, përgjithësisht Galliformet mbartin më pak sëmundje infektuese në krahasim me specie të tjera shpendësh.

Së treti, për shkak të shumë faktorëve, veçanërisht sasia e studimeve të kryera, rendi Galliformes përfshin një grup ideal shpendësh për t'u studiuar në situata eksperimentale.

Direktivat për ripopullimin e Galliformeve, për qëllime ruajtjeje janë krijuar për të zhvilluar parime bazë për ripërtëritjen në natyrë të popullatave të shëndetshme. Këto direktiva sigurojnë informacion bazë mbi qëllimin dhe objektivat e një projekti ripopullimi, si dhe problemet që duhen marrë në konsideratë gjatë fazës së planifikimit. Natyrisht që këto direktiva janë të vlefshme për të gjitha speciet e këtij rendi ku përfshihen: fazani, gjeli i egër, thëllëza etj.

Konferenca mbi Mjedisin dhe Zhvillimin e mbajtur në Rio de Janeiro në vitin 1992, çoi në Konventën e Diversitetit Biologjik. Sikurse citohet në këtë konventë, në lidhje me ripopullimet, përcaktohen detyrime midis vendeve anëtare dhe ripopullimi është një prej instrumenteve që mund të merret në konsideratë për të përmbushur këto detyrime. Nevoja për ripopullim të species mund të konsiderohet si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit dhe procesit të planifikimit të veprimeve që të gjitha shtetet firmëtare duhet të ndërmarrin. Për këtë arsye edhe ky projekt përmbush të gjitha detyrimet e kësaj konvente, ashtu si edhe ripopullimin e species gjeli i egër (*Tetrao Urogallus*).

1.2 Statusi aktual i ruajtjes

Gjeli i egër (*Tetrao Urogallus*) është një specie që në shtojcën 5 & 6 të VKM-së nr. 31, datë 20.1.2016, "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit", përfshihet në listën e kuqe të shpendëve të rrezikuar dhe nga shpjegimi i kategorisë së rrezikut, sipas IUCN-së, bën pjesë në grupimin e emërtuar "CR" që do të thotë rrezik kritik, pra lloji është në rrezik të afërt zhdukjeje në natyrë.

Habitati: Kjo specie jeton në zona malore shkëmbore, të veshura me pyje halore ose të përziera.

Gjeli i egër (*Tetrao Urogallus*) klasifikohet si një shpend tepër i rrallë në Shqipëri. Duke mbajtur statusin e rrezikuar në listën e kuqe shqiptare të specieve të kërcënuara, veprime urgjente duhet të merren për shpëtimin dhe ruajtjen afatgjatë të kësaj specie. Hartimi i një plani konservimi për këtë specie do ta vendoste problemin e ruajtjes së saj mbi baza profesionale dhe të qëndrueshme që nga

fillimi. Plani i ruajtjes së specieve do të projektohet vetëm për Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit, me qëllim që të zgjerohet në të ardhmen në nivel kombëtar.

1.3 Korniza rregullative

Konventa dhe direktiva ndërkombëtare

- Akti për ruajtjen e specieve të rrezikuara (*The Endangered Species Act ESA – 1973*)

Objektivi primar i ESA-së është të ruajë speciet vendëse të florës dhe të faunës që janë në rrezik zhdukjeje ose kërcënimi.

- Korniza Ndërkombëtare Rregullatore për Mbrojtjen e Shpendëve

- Direktiva e Shpendëve (1979) dhe direktiva e habitateteve, direktiva 2009/147/EC. Direktiva paraqet një skicë të përgjithshme se si duhet të menaxhohen, mbrohen dhe kontrollohen popullsia e shpendëve. Palët kontraktuese do të përcaktojnë Zonat e veçanta të ruajtjes, SPAs (Zona speciale për shpendë) dhe Zona të veçanta për konservimin SCAs (Territore speciale). Këto territore janë të përfshira në Rrjetin NATURA 2000.

- Konventa e Bernës (1979). Është produkti i parë i prodhuar nga bashkëpunimi ndërkombëtar për ruajtjen e specieve të florës dhe faunës. Pikat e marrëveshjes janë gati njësoj me direktivën për shpendë dhe habitate. Kjo Konventë zbatohet në një sipërfaqe të madhe gjeografike, për arsye se dhe se shumë shtete në botë janë bërë anëtare të kësaj Konvente.

- Konventa e CITES 1975, Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër.

- Konventa e Bonnit (1983). Siguron një kornizë për mbrojtjen, në të cilën shtetet pale mund të veprojnë për të mbrojtur shpendët migrues dhe habitatet e tyre. Shpendët ndahen në dy lloje të rrezikuar ose të kërcënuar. Shpendët e rrezikuar janë plotësisht të mbrojtur me rregulla strikte.

- Konventa mbi Larminë Biologjike (1992). Shtetet palë kanë përgatitur një instrument ligjor për të mbështetur larminë biologjike dhe komponentët bazë duke krijuar diversitet dhe ndarje të burimeve gjenetike.

- Konventa e Ramsarit (1971). Ramsari është një traktat ndërkombëtar që premtun ruajtjen e ligatinave me ndihmën e sanksioneve të brendshme vendimtare dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Shqipëria është palë në Konventat e mëposhtme: Konventa e Ramsarit; Konventa e CITES-it; Konventa mbi Larminë Biologjike; Konventa e Bernës; Konventa e Bonn-it.

1.4 Legjislacioni kombëtar

Ka disa akte ligjore që garantojnë mbrojtjen e natyrës në Republikën e Shqipërisë, nga të cilat mund të përmendim:

- Dokumenti i Politikave Strategjike për mbrojtjen e Biodiversitetit, i miratuar me VKM-n nr. 31, datë 20.01.2016;

- Ligji nr. 7/2014, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji është përmirësimi i gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie;

- Ligji nr. 68/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’”, të ndryshuar;

- Ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to, nëpërmjet: a) shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore, me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit; b) zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, pasurive kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit, si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm; c) lehtësimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e vlerësimit e shërbimeve të ekosistemeve (mjedisore); ç)

informimin dhe edukimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura mjedisore;

- Ligji “Për mbrojtjen e faunës së egër”, nr. 10006, datë 23.10.2008, i ndryshuar;
- Ligji “Për rregullat dhe procedurat për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës” nr. 9867, datë 31.1.2008, Fletore Zyrtare nr. 18, data e botimit 19.2.2008, faqe 629, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”;
- Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, që përafron plotësisht direktivën e Këshillit 92/43/EEC të 21 majit 1992, “Për ruajtjen e habitateve natyrore të faunës dhe të florës së egër”, miratuar më 2 korrik 2014.

1.5 Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit

Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit nr. 2027, datë 31.12.2014, është dokumenti bazë për Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit dhe për Komitetin e Menaxhimit të zonës së mbrojtur. Sipërfaqja totale e PK të Malit të Tomorit është 24,723.1 hektar dhe zë 5.37% të sipërfaqes totale të zonave të mbrojtura në Shqipëri.

Plani i menaxhimit bashkërendon dhe integron veprimet që ndikojnë mbi qëllimet e Parkut. Plani përcakton një vizion për të ardhmen e Parkut dhe specifikon veprimet dhe rezultatet që duhet të synohen.

Objektivat e Planit të Menaxhimit të PK të Malit të Tomorit janë:

- Rritja dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe tipave të ndryshëm të habitateve.
- Mbrojtja e specieve të florës dhe të faunës dhe një bashkëveprim sa më i mirë ndërmjet ekosistemeve, duke siguruar një cilësi më të mirë të lumenjve dhe të rrjedhjes së ujërave, si dhe ruajtjen e proceseve natyrore dhe biologjike unike.

1.6 Analiza e kontekstit (korniza territoriale dhe fitoklimatike)

Shqipëria karakterizohet nga një peizazh shumë i larmishëm ku peizazhet malore dhe ultësira, duke përfshirë edhe bregdetin, janë të ndërthurura në sipërfaqe shumë të vogla. Vargjet malore të mbuluar me pyje që dominojnë Shqipërinë, të ndërthurura me lugina pjellore që në shumicën e rasteve janë të orientuara nga verilindja në jugperëndim. Lumenjtë e pasur në sedimente shkarkohen në një bregdet të gjatë, duke krijuar nga veriu në jug një numër të konsiderueshëm të ligatinave dhe liqeneve, disa prej të cilave janë brenda zonave më të rëndësishme të shpendëve të të gjithë Adriatikut, ashtu si Parku Kombëtar dhe zona Ramsar e Divjaks – Karavasta dhe Peizazhi i Mbrojtur Vjosë – Nartë.

Klima është, gjithashtu, e ndryshme, mesdhetare në ultësirën perëndimore, kontinentale në anën lindore të vendit dhe kalimtare në pjesën tjetër të territorit. Kjo favorizon zhvillimin e një bimësie të larmishme e cila në anën verilindore i ngjan vegjetacionit të Evropës Qendrore, ndërsa në jugperëndim është tipike mesdhetare.

Të gjitha këto kushte krijojnë habitate shumë të larmishme dhe të përshtatshme për migrimin nga veriu në jug dhe anasjelltas, për dimërimin dhe mbarështimin e shpendëve. Shqipëria përfaqëson një nga seksionet më të rëndësishme përgjatë fluturimit adriatik [2].

Në bazë të periudhës kohore ose të sezonit, shpendët në Shqipëri ndahen, në:

- i. banorë ose të pranishëm përgjatë tërë vitit;
- ii. në mbarështues që vijnë në vend në pranverë dhe e lënë në vjeshtë;
- iii. në dimërues - shpendë që vijnë në Shqipëri në vjeshtë dhe lënë në pranverë;
- iv. në kalimtarë ose shpendë që kalojnë nëpër Shqipëri në pranverë ose në vjeshtë ose në të dyja stinët.

Bazuar në madhësinë e popullatave, në mënyrë të thjeshtë, shpendët e Shqipërisë mund të ndahen në të zakonshëm, të rrallë ose të zhdukur. Bazuar në sa më sipër, gjeli i egër (*Tetrao Urogallus*) klasifikohet si një shpend i rrallë.

Të dhënat gojore nga punonjësit e pyjeve dhe të shoqatave të gjuetarëve tregojnë se gjeli i egër ka qenë i pranishme në malet e rrethit të Tropojës, rrethit të Librazhdit, qarkut të Dibrës dhe qarkut të Beratit. Në ditët e sotme të dhënat për këtë specie janë shumë të kufizuara dhe raportet e vëzhgimit janë shumë të rralla për të mos thënë mungojnë fare.

Parku Kombëtar i Tomorit përfshin një krahinë të tërë që shtrihet në tri rrethe: Skrapar, Berat dhe Gramsh, që dominohet nga mali i Tomorit me lartësi 2416 m. Konkretisht, kontributi i secilit prej këtyre rretheve në park është, si më poshtë:

- Rrethi i Skraparit: 15045 ha

- Rrethi i Beratit: 8400 ha

- Rrethi i Gramshit: 1278 ha

Total: 24723 ha

Me vendim të Këshillit të Ministrave, datë 3.3.2009, Parkut iu shtuan edhe 1383 ha, kështu që sipërfaqja e përgjithshme aktuale e parkut është 26.106 ha.

Parku i Tomorit ka pyje ahu, pishe (robull) dhe kullota alpine që ndodhen në lartësinë 1000–2000 m mbi nivelin e detit (Dardhë, Lybeshe, Kapinovë). Pyjet e ahut i gjejmë në lartësinë 1000–1200 m mbi nivelin e detit. Pyjet e robullit gjenden në lartësinë mbi 1600 m. Parku ka edhe pyje të përziera ah me robull (Zeran).

Përveç këtyre, në florën e parkut bëjnë pjesë edhe lisi, ashja, shkoza, lajthia, dëllinja, frashëri, mëlleza, thana, mareja, shqopa, lojfta etj., si dhe 6 lloje bimësh endemike, mes të cilave *Astragalus autroni*, që gjendet vetëm në malin e Tomorit. Mbulesa barishtore përbëhet nga llojet: aguliçe, festuka, tërfil, çaj i malit, graminace etj. (fig. 1).

Bote shtazore, përveç gjelit të egër, përmban edhe lloje të ndryshme gjitarësh dhe shpendësh të egër, si: ariu, ujku, dhia e egër, derri i egër, macja e egër, lepuri i egër, dhelpra, kunadhja, baldosa, ketri, shqiponja, thëllëza e malit, disa lloje shpendësh, grifsha, mëllenja dhe disa lloje të tjera zogjsh.

Parku përmban, gjithashtu, monumente natyrore, objekte kulturore, fetare e historike, si dhe objekte të tjera në shërbim të komunitetit [3].

Lidhur me gjelin e egër mund të thuhet se numri i tyre ka rënë masivisht gjatë 20 viteve të fundit dhe vetëm mbas moratoriumit të gjuetisë prania e kësaj specie rifilloi rritjen. Në veçanti në parkun e Tomorit u identifikua një popullatë e gjelit të egër e përshtatshme për riprodhim. Gjatë monitorimit territorial është dëgjuar kënga e tyre por nuk është fotografuar ende.

Fig. 1. Harta e habitateve në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

1.7 Ekologjia dhe gjendja e popullatës së gjelit të egër në planin teorik të njohjes dhe të të dhënave paraprahe të publikuara për Parkun e Tomorit

Përshkrimi dhe biologjia e gjelit të egër (*Tetrao Urogallus L*), si dhe shpërndarja dhe statusi i tij në Botë, Evropë dhe Shqipëri

(A: Capercaillie; F: Grand Tétrás; Gj: Auerhuhn; I: Gallo cedrone; S: Urogallo)

KLASIFIKIMI: Klasa: Aves; Rendi: Galliformes; Familja: Tetraonidae.

♂ ♀

Fig. 2. Mashkulli (*Tetrao Urogallus*)

Fig. 3. Femra (*Tetrao Urogallus*)

BIOMETRIA:

- Gjatësia e përgjithshme 60–87 cm;
- Krah 30–40 cm;
- Hapja e krahëve 87–125 cm;
- Peshë ♂ 3, 4–3, 6 kg; ♀ 1, 5–2, 0 kg;
- Jetëgjatësia 15–20 vjet për gjelat dhe diçka më pak për pulat.

1.8 PËRSHKRIMI:

Ka dimorfizëm seksual të theksuar. Mashkulli ka ngjyrë të errët (fig. 2) që nga larg ngjan si e zezë. Në fakt qafa, shpina dhe krahët janë kaf në të zezë, gusha dhe gjoksi, jeshil në të zezë me shkëlqim blu, kurse supi i krahut, i bardhë. Lëkura rreth syve dhe njolla lakuriqe mbi to është e kuqe, sytë kafë, sqepi i verdhë, ndërsa bishti i zi me njolla të bardha të çrregullta. Sa më i vjetër të jetë mashkulli aq më të gjata i ka pendët e “mjekrës” dhe aq më të ngushtë e ka këndin që formohet midis sqepit dhe ballit. Kënga e mashkullit përbëhet nga dy pjesë, e para një tingull sikur goditen dy drurë të thatë dhe e dyta tingulli që lëshon mprehja e kosës (regjistrimi me poshtë).

Femra, e cila është më e vogël se mashkulli, është ngjyrë ndryshku në sfond, mbi të cilin janë vendosur njolla të zeza e të bardha (fig. 3), duke bërë që ajo të ngjajë si me lara. Pjesa e barkut është më e hapur te femra, ndërsa gjoksi kaf i hapur. Zëri i femrës përbëhet nga dy rrokje: got-got. Zogjtë që nuk kanë arritur maturitetin janë të ngjashëm me femrën në ngjyrosje.

Dallimi i sekseve të shpendëve të rinj mund të bëhet nga fundi i verës mbasi mbi kurrizin e gjelave shfaqen pendët e zeza. Ndër shqisat ka shumë të zhvilluar shikimin dhe dëgjimin. Fluturon rëndë, shkurtër nga lart poshtë dhe horizontalisht. I qëndron besnik vendit ku është mësuar të jetojë, po u tremb ikën, por rikthehet përsëri. E dëmtojnë të gjithë rrëmbenjësit shpendë apo gjitarë qofshin, të ditës apo të natës. Jeton i vetmuar jashtë periudhës së riprodhimit, kurse në dimër bashkohet në grupe nga 4–5 ekzemplarë, sipas sekseve.

1.9 AREALI DHE BIOTOPIA

Gjeli i egër është një specie palearktike e përhapur në veri të Evropës (fig. 4) dhe në Azi nga Skocia deri në Siberi dhe në Kinë, por me popullata të izoluar gjendet edhe në Evropën Qendrore dhe Jugore ku është i përherëshëm. Në vendin tonë është i përhapur në pjesën veriore, verilindore, dhe qendrore të vendit si në Valbonë, Lumi i Gashit, Martanesh, Lurë, Masdejë, Qarishtë, Orosh, Korab, Shishtavec, Tomor etj. Biotopi i tij janë pyjet halore dhe të përziera me drurë të vjetër e çeltira afër kufirit të epërm të vegjetacionit pyjor sa më larg qendrave urbane. Harta nga “*Oiseaux de France sf d'Europe*”, Jim Flegg. Një hartë e veçantë për Shqipërinë nuk ekziston.

Fig. 4. Shpërndarja

1.9.1 RIPRODHIMI:

Poligam, mosha e pjekurisë seksuale dhe sociale e gjelave është 2–4 vjet, ndërsa pulat riprodhohen në moshën njëvjeçare. Raporti normal i sekseve është 4–6 pula për një gjel (fig. 5). Kryqëzohet nga 15 marsi deri në fund të majit, duke pasur pikën më intensive nga 15 prill deri 15 maj. Me gjithë këtë, periudha e kryqëzimit është funksion i kushteve klimatike, kohës së ngrohtë dhe me dritë, e cila e shpejton atë dhe e kundërta.

Fig. 5. Western Capercaillie (mashkulli dhe femrat)

Në periudhën e kryqëzimit të dyja sekset mblidhen në pika të caktuara të pyllit të quajtura “arena”, ku ndodhin të ashtuquajturat “beteja” midis meshkujve dhe “paradat e dashurisë”.

Këto pika janë pjesë pylli prej 5–10 ha në formë çeltirash me drurë të rrallë e të vjetër, që zakonisht gjenden afër kufirit të epërm të vegjetacionit pyjor të cilat duhen diktuar dhe mbrojtur nga mbarështimi i pyjeve

Fig. 6

Gjelat grumbullohen në këto pika, duke ardhur në fluturim ose më këmbë, kurse femrat vijnë si rregull në fluturim 2–3 javë më vonë. Gjelat flenë në majën e drurëve dhe në mëngjes rreth një orë para se të gdhiet fillojnë këngën. Në kohën e paradave të dashurisë, gjeli lëshon krahët poshtë (fig. 7), hap bishtin në formë erashke dhe zgjat qafën përpara. Të njëjtën gjë bëjnë edhe femrat. Kryqëzimi bëhet në tokë pasi del drita.

Fig. 7. Mashkulli dhe femra në paradën e dashurisë

Femrat e bëjnë çerdhen në tokë në një gropëz në mes të bimësisë. Në maj pjell 5–9 vezë me ngjyrë të verdhë në të kuqerremtë, me njolla kafe e dimensione (5,8 x 4,1 cm) (fig. 8). Intervali i pjelljes së vezëve është një ditë, ndërsa inkubacioni fillon mbas pjelljes së vezës së fundit dhe kryhet vetëm nga femra.

Fig. 8. Vezët

Deri nga fundi i gushtit pulat arrijnë të japin mesatarisht 2–3 shpendë për pulë, duke pasur një tregues mesatar riprodhimi prej 0,7 shpendë të rritur për pulë. Shpendët janë nidifugë. Në momentin e çeljes janë të mbuluar me një push të verdhë me njolla të zeza në kokë dhe në qafë dhe njolla kafe në shpinë e krahë. Disa orë mbas çeljes shpendët braktisin çerdhen, kurse 8–10 ditë mbas çeljes janë në gjendje të fluturojnë. Shpendët ndahen nga femra mbasi të kenë mbushur moshën 4 muajsh, kohë kur arrijnë edhe peshën e të rriturve. Përqindja vjetore e mbijetesës është 70–90 % te meshkujt dhe 60–80 % te femrat.

Përqindja e mbijetesës e të rinjve nga mezi i gushtit deri në muajin pasardhës është 35%. Mbas riprodhimit ndodh ndërrimi i pendëve, i cili vazhdon deri në gusht. Është shpend dite, që në verë haset si rregull në tokë, kurse në dimër mbi drurë, i qëndrueshëm. Fle mbi drurë bile shpesh për disa net në të njëjtën degë.

Fig. 9. Jashtëqitjet e gjelit të egër

1.9.2 RITMI I AKTIVITETIT DITOR

Gjeli i egër është aktiv sidomos në fillim dhe në fund të ditës. Në agim ai lë vendin ku ka fjetur (që si rregull është një degë e një druri të lartë) në kërkim të ushqimit. Ky dru shpesh diktohet nga prezenca nën kurorën e tij të jashtëqitjeve të gjelit.

Mbasi ngopet ai kalon pjesën tjetër të ditës i fshehur në barin e lartë ose në filizerinë e dendur, nën degët e ulëta të një druri ose hipën përsëri në degët e larta të drurëve, sipas stinës. Kjo periudhë e gjatë çlodhjeje shpesh ndërpritet nga periudha të shkurtra aktiviteti që i kushtohen të ushqyerit ose për të bërë banjat e tij të pluhurit. Në sezonin e riprodhimit meshkujt fillojnë të këndojnë një orë para daljes së diellit dhe mund të qëndrojnë në arenë nga një deri në tetë orë në funksion të kushteve atmosferike, numrit të shpendëve në arenë, prezencës ose mungesës së pulave etj.

Aktiviteti i këngës rifillon në mbrëmje, por është më i shkurtër. Ndryshe nga të rriturit, të rinjtë ushqehen thuajse gjithë ditën afërsisht 16 orë në korrik, nëse temperatura është e mjaftueshme. Gjatë kohës së keqe shpendët mund të qëndrojnë për një kohë të gjatë nën krahët e nënës së tyre në vend që të ushqehen. Në këtë rast mund të ndodhin humbje të rëndësishme.

Meshkujt kanë tendencën të mbrojnë një territor riprodhimi sa më afër që të jetë e mundur nga vendi ku kanë lindur dhe të rikthehen po në vendin ku kanë lindur për të kryer linjërzhimin veror, ndërsa femrat qëndrojnë në vende dimërimi dhe riprodhimi më larg nga vendi i tyre i lindjes, duke bërë gjatë jetës së tyre një migrim stinor midis dy zonave që ndonjëherë janë disa kilometra larg njëra-tjetrës.

1.9.3 USHQIMI

Të rriturit konsumojnë kryesisht ushqim bimor, por regjimi i tyre ushqimor varion sipas stinës.

Nga nëntori deri në prill ai përbëhet thuajse vetëm nga rreth 250 gr në ditë hala koniferësh, si *Pinus silvestris*, *Pinus uncinata*, *Abies alba*, *Juniperus communis* etj., të cilat shpendi mund t'i asimilojë në saje të aparatit tretës dhe të zorrëve të tij të mëdha që janë degëzime të tubit tretës, të cilat përmbajnë një florë bakteriale të aftë të transformojë celulozën.

Në periudhën prill–maj, rritja e nevojave energjetike të shkaktuara nga aktiviteti riprodhues bën që gjeli i egër të kërkojë ushqime të pasura në proteina. Kështu ai konsumon në këtë kohë mbirje të

ahut *Fagus silvatica*, të *Sorbus aucuparia*, të *Vaccinium myrtillus*, bisqe të shëlgjeve *Salix sp*, të mëshëtknes *Betula verucosa*, si dhe lulesa dhe mbirje të reja të bimëve barishtore.

Regjimi i tij ushqimor diversifikohet nga qershori në shtator, duke konsumuar rreth 150 lloje bimësh barishtore, si dhe fruta të *Vaccinium myrtillus*, *Rubus idaeus* dhe *Sorbus aucupria*. Ky ushqim i pasur i jep atij energjinë e nevojshme për zëvendësimin e pendëve gjatë linjësimit. Të ushqyerit në vjeshtë konsiston në kalimin drejt regjimit ushqimor dimëror. Për tretjen e ushqimit, gjeli i egër, si të gjithë galiformët gjellit edhe gastrolite.

Shpendët e rinj ushqehen me arthropode gjatë 4 javëve të para të jetës pastaj kalojnë progresivisht në regjimin ushqimor të të rriturve.

1.9.4 GJUEITIA: Në vendin tonë është plotësisht e ndaluar. Është e lejuar me rregulla në Austri, Bjellorusi, Bosnjë, Bullgari, Finlandë, Francë, Kazakistan, Norvegji, Rumani, Rusi, Sllovaki.

2. Njohja reale e gjendjes së tanishme e popullatës (popullatave) të gjelit të egër në Parkun e Malit të Tomorit

2.1 Sipërfaqja e përhapjes reale të gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

1. Vlerësimi i sipërfaqes reale të përhapjes së gjelit të egër në Parkun e Tomorit, me qëllim që pastaj të gjenden arsyet e dendësisë së tij të vogël dhe të propozohen në vazhdim masa për shpëtimin e tij duke propozuar forma konkrete të mbrojtjes dhe mbarështimit të popullatës (apo popullatave nëse do të ekzistojë më shumë se një e tillë).

2. Parku i Tomorit, në tërësinë e tij prej 26106 ha përbëhet nga pjesë (sipërfaqe) me destinacione dhe përdorime nga më të ndryshmet, si: pyje, kullota, sipërfaqe për qëllime turistike, fetare, sipërfaqe ujore apo për përdorim bujqësor etj.

3. Duke pasur parasysh karakteristikat biologjike të species e sidomos veçantitë e saj lidhur me kërkesat ekologjike (masive pyjore me drurë të vjetër, çeltira, nën pyll e bimësi barishtore të variueshme), nevojën e paneglizueshme të ekzistencës së një qetësie të domosdoshme larg qendrave të banuara e veprimtarive bujqësore, turistike, fetare etj., lindi nevoja që puna për përcaktimin e sipërfaqes së përhapjes së gjelit në park të ndjekë ritmikën kohore të mëposhtme:

- kërkime paraprake;
- grumbullimi i të dhënave në terren.

Paraqitja kartografike e të dhënave dhe përpunimi i modeleve të punës për përmirësimin e gjendjes.

2.2 Kërkime paraprake

Përpara se të kryhen punime në terren që lidhen me studimin e *parametrave të popullatës* referuar [1] së gjelit të egër në Parkun e Tomorit dhe përcaktimin e *sipërfaqes së përhapjes* së tij do të bëhen disa studime paraprake “në tavolinë”, duke përdorur dokumentacionin ekzistues që do të grumbullohet si:

- dokumentacioni teknik aktual i parkut;
- dokumentacione të ish-DSHP-ve, shoqatave të gjuetarëve të të tria rretheve;
- organizmi i një anketimi të banorëve lokalë (pylltarë, bujq, gjuetarë, mësues, nxënës shkollash etj., lidhur me konstatimet që ata mund të kenë bërë me kohë për ekzistencën e gjelit të egër në park (sipas modelit të një ankete që mund të krijohet).

Sigurisht të dhënat e grumbulluara në këtë mënyrë do vlerësohen me kujdes duke i ndarë ato që janë të sigurta nga informacionet që kërkojnë një verifikim të mëtejshëm.

Puna e bërë me dokumentacionin e sipërpërmendur do të japë mundësinë të përcaktojmë sipërfaqet që meritojnë të studiohen në vazhdim, të cilat potencialisht janë sipërfaqe të shpërndarjes reale të llojit në objekt.

Do të krijohet kështu një imazh i parë i habitatit gjeografik të gjelit të egër, duke përjashtuar nga studimi territoret e papërshtatshme apo pak të frekuentuara nga lloji.

Kështu mund të përjashtohen:

- sipërfaqet që ndodhen në një altitudë nën 1200 m;
- sipërfaqet me bimësi pyjore të zonës fitoklimatike *lauretum* dhe *castanetum*;
- sipërfaqet e antropizuara;
- sipërfaqet me altitudë mbi 1900 m, të cilat normalisht nuk përmbajnë formacione pyjore.
- kjo do të bëjë të mundur një kategorizim të parë të territorit, i cili do të paraqitet në tabelën 1:

Tipi i mbulesës	Ha
Pyje halorësh (robull, pish)	27.9
Pyje fletorësh (ah, bunge, panjë mali)	90
Pyje të përziera (...)	47.8
Kullota masive	2.3
Livadhe	4.75
Toka bujqësore	0
Sipërfaqe inproduktive (shkëmbore etj.)	47
Sipërfaqe të urbanizuara	0
Shkurre	52.55
Sipërfaqe boshe	2.3
TOTALI	274.6

Tabela 1. Kategorizimi i territorit

Kështu eliminohen nga kërkimi sipërfaqet e urbanizuara, ato bujqësore, livadhet, sipërfaqet shkëmbore inproduktive dhe kullotat masive. Përcaktohen në këtë mënyrë sipërfaqet ku potencialisht mund të ekzistojë gjeli i egër dhe ku do të zhvillohen kërkimet në vazhdim. Në tërësi për Parkun e Tomorit kjo sipërfaqe rezulton të jetë: 184.55 ha.

2.3 Studimi i tipave të pyjeve që hasen në habitatin e gjelit të egër në Parkun e Tomorit, bazë për përcaktimin e dimensioneve të popullatës së tij

Në bazë të të dhënave të dokumentacionit ekzistues do të përkufizohen në terren dhe në hartë tipat e pyjeve që ekzistojnë në zonën e përhapjes së gjelit të egër. Për çdo tip pylli do të përcaktohet:

1. Emërtimi i tipit të pyllit, i cili do të jetë në përputhje me emërtimet klasike të silvikulturës, p.sh.:
- *Pinetum eldreihii* me ... (llojet treguese barishtore ...);
- *Fagetum ... (asperuletosum)* etj.

2. Shtrirja e çdo tipi pylli do të përfshijë pjesë të mëdha pylli që mund të përbëhen nga më shumë se një nënparcelë, sipas ndarjes së vjetër parcelare të mbarështimit.

3. Struktura e grumbujve pyjorë brenda çdo tipi pylli.

4. Nënpylli, duke përshkruar: shkallën e mbulimit, përbërjen, lartësinë, vlerën ushqimore etj.

5. Bimësia barishtore, duke përshkruar: përbërjen, shkallën e mbulimit, vlerën ushqimore etj.

Mbi çdo pjesë të tillë sipërfaqeje (pra mbi çdo tip pylli) do të vazhdojnë të kryhen pastaj punimet për grumbullimin e të dhënave, siç tregohet më poshtë.

2.4 Grumbullimi i të dhënave në terren lidhur me dimensionet e popullatës së gjelit të egër në Parkun e Tomorit

Këtu duhet përcaktuar:

1. Prezenca e saktë të llojit (në territorin e presupozuar të ekzistencës së tij);
2. Dendësinë, pra mundësinë për të njohur numrin e individëve për njësi sipërfaqeje dhe për krejt territorin;

Fig. 10. Harta e shtrirjes së territorit ku është dëgjuar gjeli i Egër

Për të bërë monitorimin e gjelit të egër (pra për të përcaktuar prezencën dhe dendësinë) mund të përdoren metoda të ndryshme, të cilat ndryshojnë nga njëra-tjetra nga periudha e vitit kur kryhet monitorimi, saktësia e të dhënave që synohet të grumbullohen, si dhe koha e punës dhe e fondeve që disponohen.

Në vazhdim do të përshkruajmë shkurtimisht përmbajtjen e këtyre metodave:

2.5 Metodat e monitorimit të popullatave të gjelit të egër

Nga literatura dallohen tre tipa monitorimi:

- a) monitorimi në periudhën e riprodhimit;
- b) monitorimi veror;
- c) monitorimi dimëror.

Monitorimi i popullatave kërkon një njohje të mirë të terrenit dhe një motivim, i cili të garantojë etikën e punës së kryer. Që të mund të vlerësohen dhe të shfrytëzohen si duhet rezultatet ato duhet të formalizohen dhe të standardizohen. Prandaj të gjitha veprimet (aksionet) që do të ndërmerren duhet të parashikohen në një material të hartuar paraprakisht, sikurse po veprohet në rastin konkret, i cili nuk duhet të ndryshohet deri në fund të punimeve.

Në fakt nga shumë autorë janë hartuar (parashikuar) metoda të ndryshme të vrojtimit (monitorimit), si dhe kartelat (formularët) teknike përkatëse, që do të përdoren për regjistrimin e të dhënave. Në çdo rast koordinatori (zbatuesi) lokal i kërkimeve është përgjegjës për funksionimin e mirë të dispozitivit të hartuar.

2.6 Monitorimi në periudhën e riprodhimit

Në këtë epoke mund të përfitohet një maksimum të dhënash me një minimum shqetësimi, me kusht që të respektohen rigorozisht metodat e parashikuara. Konkretisht janë hartuar tri metoda [9][1]:

- a) Numërim duke vëzhguar nga pika fikse

Metodë që zbatohet në vende fikse (të qëndrueshme), që nuk janë gjë tjetër veçse sipërfaqet e këngës (arena), kur ato janë diktuar prej kohësh nga kënga e meshkujve. Këto pika shënohen në hartë nëpërmjet aparatit GPS, me të cilin duhet të jenë pajisur vrojtuesit.

- Objektivi i metodës: Përveç numërimit të shpendëve grumbullohet, gjithashtu, një maksimum të dhënash lidhur me sjelljen e tyre.

- Metoda e punës

Vrojtuesi vendoset në vendin e vrojtimit para orës 17:00 të ditës para ditës së parashikuar për numërim. Ai do të largohet nga vendi i vrojtimit të nesërmen, duke filluar nga ora 10:00 ose ekzaktësisht një orë mbas momentit kur është konstatuar për herë të fundit prezenca e shpendëve (qoftë dhe e një ekzemplari të vetëm). Një kujdes shumë i rreptë duhet treguar si në përgatitjen e pikës së vrojtimit, afrimin tek ajo dhe maskimin e saj, ashtu edhe gjatë gjithë vrojtimit dhe daljes prej saj.

b) Numërimi me anë të afrimit dhe vrojtimit të kombinuar

Metodë që zbatohet në rastin e vendeve të këngës të paqëndrueshme ose që dihen me përafërsi por jo saktë.

- Objektivi i metodës: Të lokalizohen dhe numërohen shpendët.

- Metoda e punës

Puna në grup: Koordinatori lokal përcakton një numër pikash vrojtimi, në të cilat ai vendos vrojtuesit qoftë një ditë para, qoftë në rastin më të vonët, dy orë para daljes së diellit. Vendet e vrojtimit nuk mund të lihen para orës 10:00 e në rastin më të hershëm një orë mbas konstatimit të fundit të prezencës së shpendëve. Një kujdes shumë i rreptë duhet treguar si gjatë përgatitjes së pikave të vrojtimit, ashtu edhe gjatë vrojtimit dhe largimit nga pika përkatëse.

Puna individuale: Vrojtuesi aplikon metodën e kërkimit me anë të këngës (shih metodën më poshtë), me qëllim që të lokalizojë zonën ku janë shpendët. Gjatë vizitave të tij të tjera në arenat, tashmë të përcaktuara, vrojtuesi zbaton metodën e vëzhgimit nga pika fikse.

c) Kërkimi me anë të këngës

Metodë që zbatohet në zonat ku nuk ka vende (sipërfaqe) të këngës të përcaktuara mirë dhe në zona ku presupozohet se ka prezencë të shpendit (sipas të dhënave të reja ose të vjetra).

- Objektivi i metodës: Të lokalizohet vendndodhja ose të shënohen kontakte zanore ose vizuale me shpendët.

- Metoda e punës: Vrojtuesi parashikon një itinerar të lëvizjes së tij në zonën ku presupozohet se ka shpendë, njëloj siç veprohet në rastin e metodës së inventarizimit me vrojtues të lëvizshëm “transekt” (për detaje shih librin “Biologjia dhe mbarështrimi i faunës së gjuetisë”, A. Postoli 2017). Këtë itinerar ai e përshkon të shumtën një herë në muaj nga marsi në qershor, qoftë shumë herët në mëngjes për të kërkuar një kontakt zanor, qoftë ditën për të kërkuar tregues të tjerë. Në të gjitha rastet lëvizjet (spostimet) konkretizohen në një plan ditor dhe stinor që hartohet nga drejtuesi i kërkimeve të terrenit dhe bëhen me kujdes dhe koncentrim të madh të vëmendjes, me qëllim që të rriten shanset për të pasur “indicie” dhe për të limituar shqetësimet. Në rastin e një kontakti zanor ose vizual nuk duhet tentuar t’u afroresh shpendëve. Të gjitha konstatimet e realizuara nga vrojtuesit i transmetohen në fund të çdo dite pune drejtuesit të kërkimeve në terren i cili nga ana e vet bën të njëjtën gjë ndaj drejtuesit të punimeve në rang parku.

2.7 Monitorimi në periudhën dimërore

a) Kërkimi dimëror (varianti i parë):

Metodë që zbatohet gjatë daljeve dimërore sidomos në zonat në të cilat presupozohet një prezencë e shpendëve (të dhëna të reja ose të vjetra).

- Objektivi i metodës: Të rilevohen tregues dimërorë

- Metoda e punës: Të përcaktohet dhe të paraqitet në kartelën e kërkimeve dimërore plani i një përshkimi të terrenit, i cili mund të kontribuojë në mbledhjen e indekseve dimërore. Midis nëntorit dhe shkurtit, kur kushtet janë të favorshme, të realizohen dy përshkime (kalime të tipit transekt) të terrenit dhe të shënohen të gjitha vërtetimet (konstatimet) në kartelën e përmendur më sipër. Nuk bëhet asnjë përshkim tjetër dimëror, për të mos shqetësuar individët që dimërojnë në sektorin përkatës.

b) Kërkimi dimëror (varianti i dytë)

Metodë që zbatohet gjatë daljeve dimërore në korridoret e qarkullimit, veçanërisht në zonat ku prezenca e shpendëve është vërtetuar, me qëllim që të njihen kushtet e dimërimit të llojit.

- Objektivi i metodës: Të zbulohen treguesit e mundshëm dimërorë dhe të mbikëqyret frekuenca e tyre.

- Metoda e punës: Vërtetuesi përshkon më këmbë zonën ku është i përhapur shpendi dhe kërkon gjurmë të ndryshme të hyrjes së shpendit, duke shfrytëzuar brenda mundësive ndihmën që jep shtresa e dëborës që mund të jetë prezente. Të gjitha gjurmët e ekskrementeve, pendëve etj., të konstatuara i përcillen koordinatorit gjatë bilancit të daljeve dimërore (transekt).

2.8 Monitorimi veror

Në disa zona pilot, duke përfutur nga statusi i veçantë i procesit të menaxhimit, një monitorim veror i riprodhimit komplet format e tjera të monitorimit, me qëllim që të plotësohet vlerësimi i ndikimit të masave që janë zbatuar.

- Objektivi i metodës: Në një sektor të dhënë grumbullohen maksimumi i treguesve të cilët lejojnë të vlerësohet suksesi i riprodhimit të llojit.

- Metoda e punës: Kërkohen tregues në një kalim të caktuar (transekt) në kërkim të gjurmëve të riprodhimit (lëvizja vezësh, vezë të paçelura, pupla) dhe tregues të prezencës verore (pupla të linjëzimit etj.). Mund të përdoret edhe metoda me çuarje për përcaktimin e numrit të shpendëve. [1]

2.9 Praktika e monitorimit

Në rastin e studimit tonë monitorimi do të bëhet:

a) Gjatë periudhës maj–qershor (kur shpendët janë në fazën e arenave), duke përdorur “metodat e monitorimit gjatë periudhës së riprodhimit” ose “periudhës së këngës”, siç quhet duke përfshirë si këngën e natës ashtu dhe atë të ditës) për të gjetur gjurmë eventuale të prezencës së shpendit.

b) Gjatë periudhës së verës korrik–shtator, që përkon me fazën e rritjes së të vegjëlve, duke përdorur “metodën e kërkimit veror”.

Numri i vërtetimeve (fiks) apo i kalimeve (transekt), si dhe i sipërfaqeve përkatëse të prekura nga studimi do të përcaktohet në terren, në bazë të:

- të dhënave paraprake orientuese mbi përhapjen e gjelit;
- shtrirjes dhe konfiguracionit të zonës së përhapjes së shpendit;
- numrit të popullatave të presupozuara se ekzistojnë.

Paralelisht me vërtetimet e bëra për prezencën dhe dendësinë e specit (gjelit) do të grumbullohen edhe të dhëna me karakter ambiental në vendet (zonat) në të cilat konstatohet prezenca e shpendit. Në këto vende përcaktohen sipërfaqe rilevimi kampion për të studiuar karakteristikat pyjore dhe të vegetacionit. Këto sipërfaqe bëhen rrethore me rreze 20 metra, në të cilat përcaktohet:

- përbërja e pyllit;
- kurorëndësia dhe trungdendësia e pyllit;
- nënpylli, përbërja e tij, shkalla e mbulimit, lartësia etj.

Një punë e ngjashme bëhet edhe për vegetacionin barishtor për grumbullimin e të dhënave të sipërfaqeve kampion të zgjedhura. Përpunimi i të dhënave pyjore dhe i atyre të vegetacionit, lidhur ky edhe me panoramën e përgjithshme të krejt territorit do të lejojë të përcaktohen korrelacione të rëndësishme mbi preferencat që gjeli i egër ka lidhur me habitatin.

2.9.1 Rezultatet e rlevimeve

2.9.2 Rilevime (numërime) pranverore

Të dhënat e grumbulluara nga rilevimet pranverore do të grumbullohen e paraqiten në një tabelë si më poshtë (tabela 2):

Vendi (grupi i nënparcelave) ku është kryer vrojtimi me kalim (transekt)	Vrojtim direkt	Gjurmë	Viti i rilevimit	Karakterizimi i vendit të këngës (arenës)
1. Shpati i...	X	X	2019	I sigurt
2. Pylli i ...	-	X	2019	I mundshëm
•	•	•	•	•
•	•	•	•	•

Tabela 2. Rilevimet pranverore

Në funksion të të dhënave të grumbulluara dhe përpunuara do të nxirren pastaj konkluzione lidhur me prezencën e gjelit të egër në vendin përkatës, dendësinë e tij dhe sigurinë e pohimeve përkatëse.

2.9.3 Rilevime verore

Tregohet sa përkime të territorit (grup-parcelave) janë bërë me metodën “transeks”, duke shënuar konstatimet, si për prezencën e shpendëve, ashtu dhe gjurmët e tyre (pupla, glasa etj.). Edhe për këtë rast të dhënat pasqyrohen në një tabelë si tabela 2.

Bëhen, gjithashtu, rilevime me metodën e çuarjes në zona ku presupozohet se femrat realizojnë rritjen e të vegjëlvë. Për këto zona bëhet:

- Përshkrimi i zonës (bimësia, relievi etj.);
- Sipërfaqja e çuarjes (si rregull, rreth 50 ha);
- Kundrejtimi;
- Numri i nevojshëm i çuarjeve;
- Gjatësia maksimale e çuarjeve (si rregull 1300–1600 m);
- Të dhënat e çuarjeve përmbledhen në një tabelë si më poshtë tabela 3.

Emërtimi i sipërfaqes e përshkuar nga çuarja dhe madhësia ha	Data e numërimit	Vrojtuesit e çuarjeve	Rezultatet
1. Pusi i ... 50 ha	25.6.2019	9	Kemi 11 sinjalizime të gjelit nga të cilat: 1 çerdhe (mbetjet) 1 femër e ngordhur 5 shenja glasash 4 shenja puplash
•	•	•	•
•	•	•	•
•	•	•	•

Tabela 3. Të dhëna mbi çuarjet

Kështu plotësohet tabela edhe për sipërfaqe të tjera ku eventualisht janë bërë çuarje. Këto të dhëna (pra numri i gjurmëve apo sinjalizimeve) shërbejnë për të vlerësuar numrin e shpendëve, duke lejuar njëkohësisht përcaktimin apo konfirmimin e sipërfaqeve me të favorshme për rritjen e shpendëve të rinj.

Përpunimi i të dhënave bëhet sipas udhëzimeve të treguara për metodën e numërimit (inventarizimit) me sipërfaqe prove fikse dhe për metodën e numërimit me anë të përshkimit (apo e vrojtuesit, vrojtimit të lëvizshëm – transekt).

3. Gjendja e popullatës së gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Mali të Tomorit.

3.1. Efektiviteti i vlerësuar për tërë parkun (nëse do të kemi të bëjmë me një popullatë të vetme) ose për pjesë të caktuara të tij (nëse do të kemi të bëjmë me më shumë se një popullatë).

Për kuptimin e konceptit të popullatës dhe mënyrën e përkufizimit i referohemi literaturës [1]. Përcaktimi i numrit të individëve për çdo popullatë do të bëhet duke përdorur metodologjinë e llogaritjes për secilën metodë të përshkruar në literaturën [1].

3.2 Fiksimi në hartë dhe përshkrimi i vendeve të këngës (arenave) të determinuara bazë për përsëritjen e numërimeve në vitet e ardhshme

Duke përdorur një hartë 1:25000 dhe një pajisje GPS, hidhen në të vendet e këngës që është arritur të diktohen dhe bëhet përshkrimi i tyre, duke dhënë sipërfaqen, duke përshkruar bimësinë e arenës si mbulesën drunore atë të nënpyllit dhe bimësinë barishtore me të gjitha elementet e tyre si përbërja, kurorëndësia, mosha, gjendja fitosanitare etj.

Vendet e këngës rankohen edhe sipas prezencës e sidomos numrit të ekzemplarëve që i frekuentojnë, intervalit kohor kur ndodh kjo (ditor dhe mujor) etj.

Për vendet e këngës shikohet edhe mundësia që ekziston për ndërtimin e “kullave vrojtuese” (fig. 11) si pajisje të qëndrueshme për numërim por edhe për promovimin e gjelit të egër për ta fotografuar dhe zhvilluar turizmin elitare.

Fig. 11. Tip, kullë vrojtimi

3.3 Kërcënime ndaj popullatës së gjelit të egër në masivin e Malit të Tomorit

Sikurse tregohet nga të dhënat ekzistuese të publikuara nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Berat popullata e gjelit të egër në Malin e Tomorit ka pësuar rënie të madhe, por sot mbas zbatimit të moratoriumit të gjuetisë konstatohet një popullatë e aftë të riprodhohet por që nuk është arritur të fotografohet.

Prandaj, lidhur me kërcënimet që ekzistojnë ndaj gjelit të egër do të bëhen vlerësime me anë të dokumentacionit ekzistues:

- a) të dhëna të ish-DSHP-ve Berat, Skrapar dhe Gramsh;
- b) të dhëna të shoqatave të gjuetarëve të këtyre rrethëve (nëse këto të dhëna ekzistojnë).

Anketimit që duhet bërë nga ADZM Berat me popullsinë lokale, pylltarët, nxënësit e shkollave dhe gjuetarët duhet të bazohet, në:

a) Vrasjet që mund të jenë bërë gjatë 5 viteve të fundit nga gjuetia e paligjshme (brakonazhi) e cila është vështirë të zbulohet.

b) Sëmundjet: Edhe pse treguesi i sëmundjeve infektive dhe parazitare të gjeli i egër është i vogël, në rastin kur shpendët d.m.th. zona e përhapjes së tyre reale, është afër zonave ku ka një aktivitet të caktuar njerëzor (fshatra, shpendë të buta, restorante ku konsumohet mish shpendësh të buta dhe të egra, pista të lëvizjes së turistëve etj.) nga studimet e kryera në vende të tjera të zhvilluara, konstatohet se infestimi nga koksidet, certodat, dhe nematodat mund të përbëjë një rrezik të rëndësishëm për gjelin e egër.

c) Predacioni: Nga zardafi, kunadhja dhe dhelpra, i cili ndodh mbi vezët në çerdhe të cilat ndërtohen në tokë dhe ndaj shpendëve të rinj deri sa janë më të vegjël se 10 ditë është faktori kryesor që kufizon suksesin e riprodhimit të gjelit të egër.

Edhe derri i egër kur është tepër i dendur në numër është një dëmtues i rëndësishëm i çerdheve dhe i shpendëve të rinj. Predacioni i shpendëve rrëmbenjës është gjithashtu një faktor i rëndësishëm që rrit mortalitetin e gjelave të rinj por edhe të të rriturve.

Për këto arsye gjatë vrojtimeve në terren për rëlevimet e të gjitha llojeve do të përqipemi të vrojtjeve edhe dendësinë e këtyre rrëmbenjësve për të parashikuar më pas masa për kufizimin apo edhe luftimin e tyre.

d) Infrastrukturat dhe frekuentimi turistik i parkut

- Rugët e hyrjes dhe të aksesit në park, ndërtesat, pistat e skive, zonat e pelegrinazhit fetar, ato të piknikut etj., shkaktojnë një zvogëlim kuptimplotë të popullatës së gjelit që mund të çojë deri në zhdukjen e tij.

- Mortaliteti i shkaktuar nga kabllot elektrike ndikon, gjithashtu, negativisht mbi dinamikën e popullatës së gjelit të egër.

- Ekzistenca e rrugëve pyjore dhe atyre të qarkullimit të kopeve shpesh janë shkak i intensifikimit të punimeve silvikulturale dhe zooteknike që ngandonjëherë prekin cilësinë e habitateve, mbasi ato sjellin në mënyrë thuajse sistematike një rritje të veprimtarive turistike, dhe të gjuetisë. Megjithatë këtu mund të thuhet se aktivitetet turistike verore (si ekskursionet të drejtuara etj.) janë më pak të dëmshme për gjelin e egër se sa ato dimërore me përjashtim të rasteve kur ato janë tepër masive dhe të paorganizuara mirë.

e) Degradimi dhe modifikimi i habitateve

Në shumë vende të botës degradimi dhe modifikimi i habitateve ka qenë faktori më i rëndësishëm i pakësimit progresiv të këtij shpendi të egër. Ndër këta faktorë negativë më të rëndësishmit janë:

- Zvogëlimi ose ndalimi i plotë i kullotës në pyje;

- Intensifikimi i prodhimit silvikultural (plantacione pyjore me dendësi të madhe, konvertimi i pyjeve në trungishte të rregullta, ripërtëritja masive e pyjeve) dhe të gjitha praktikat që çojnë në përgjithësi në një mbyllje pak a shumë totale të grumbujve dhe në një mbyllje të nënpyllit dhe të vegetacionit barishtor;

- Degradimi dhe shkatërrimi i kateve të ulëta të vegetacionit pyjor të domosdoshme për shpendët e rinj;

- Mbrojtja e pyllëzimeve të reja apo e kulturave të tjera brenda habitatit të gjelit me rrethime me rrjet teli;

- Të gjitha këto janë shkaqe të një mortaliteti të lartë të gjelit të egër.

f) Kushtet meteorologjike dhe ndryshimi i tyre

- Kushtet meteorologjike gjatë periudhës së riprodhimit (nga periudha para pjelljes së vezëve deri në javët e para të jetës së shpendëve të vegjël) influencojnë fuqimisht mbi suksesin e riprodhimit. Kështu një rritje e reshjeve dhe zvogëlim i temperaturave (nga ajo normale) gjatë periudhës së riprodhimit ka një efekt direkt mbi produktivitetin e riprodhimit.

- Përveç këtyre analizat me të fundit të kryera në vende të zhvilluara tregojnë se ka një tendencë që gjeli i egër të riprodhohet më herët (nga pikëpamja stinore) gjë që bën që kulmi i çeljeve të korrespondojë në një periudhë me kushte meteorologjike të dëmshme për shpendët e rinj.

4. Identifikimi i vendimmarrësve dhe aktorëve të tjerë që janë përfshirë direkt në menaxhimin e habitatit/species dhe analiza SWOT

4.1 Autoritetet qendrore

- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)** ka rolin kryesor të politikëbërjes dhe të monitorimit për ruajtjen e natyrës në Shqipëri. Detyrat kryesore të MTM-së, në lidhje me biodiversitetin janë:

- zhvillon dhe publikon strategji/plane për komponentët e mjedisit;
- zhvillon dhe miraton kornizën ligjore për mbrojtjen e mjedisit;
- miraton dhe monitoron standardet mjedisore;
- informon dhe ndërgjegjëson komunitetet për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm.

Ministria ka disa institucione në varësi të përdorura si organe teknike në përmbushjen e detyrave. ata janë:

- **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).** Është një institucion publik që punon në gjithë territorin, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Mjedisit. Detyrat kryesore të Agjencisë kanë të bëjnë me monitorimin e elementeve mjedisore dhe raportimin përmes “Raportit të gjendjes së mjedisit”. Një tjetër detyrë është edhe leja mjedisore përmes procesit të VNM-së.

- **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)** e themeluar në shkurt të 2015, me strukturat e saj rajonale (administratat rajonale të zonave të mbrojtura) është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura dhe zbatimin e planeve të menaxhimit. Staf i administratës së zonës së mbrojtur ka funksion koordinues dhe informativ për të siguruar një zbatim më të mirë të praktikave ligjore, në lidhje me ruajtjen e natyrës, biodiversitetit, zonat e mbrojtura dhe peizazhin.

- **Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ADZM, Berat** është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura dhe zbatimin e planit të menaxhimit për Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit.

- **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:** Kjo Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka katër shtylla kryesore: i. energjinë; ii. zhvillimin e infrastrukturës; iii. zhvillimin industrial, iv. zhvillimin urban.

Institucioni kryesor në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për planifikimin hapësinor është **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)**, përgjegjëse për koordinimin e proceseve të hartimit të dokumenteve të planifikimit territorial dhe të zhvillimit, të cilat janë ndërmarrë nga autoritetet e planifikimit në nivel qendror dhe lokal.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)** është institucioni kryesor qeveritar që merret me bujqësinë dhe zhvillimin rural.

- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me Drejtorinë Arsimore Rajonale, qarku Berat,** të cilat promovojnë përmes përfshirjes së informacionit për ruajtjen e habitateve/specie në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit në kurrikulat arsimore.

- **Institucionet kërkimore dhe universitetet.**

4.2 Autoritetet lokale

- **Njësitë e qeverisjes vendore** (komunat, njësitë administrative), detyrat kryesore janë miratimi i instrumenteve të planifikimit, lëshimi i lejeve për zhvillim dhe ndërtim, miratimi i rregulloreve të planifikimit dhe ndërtimit në nivel lokal, sigurimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve, përfshirë furnizimin me ujë dhe kanalizimet, menaxhimin e integruar të mbetjeve etj.

- **Prefekturat e Beratit dhe Gramshit** kanë për detyrë të kontrollojnë përputhshmërinë ligjore të vendimeve të bëra nga njësitë e planifikimit lokal.

- **Organizatat dhe shoqatat jofitimprurëse**, të cilat mbështesin iniciativat e komunitetit lokal, duke përfshirë zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe aktiviteteve të tjera lokale ekonomike, ruajtjen e biodiversitetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit. Shoqatat më të rëndësishme dhe ato që luajnë rol në mbrojtjen e habitateve/specieve janë PPNEA, INCA.

- **Shoqatat e gjuetisë**, ndalimi i gjuetisë së paligjshme dhe përmirësimi i habitateve për specie të veçanta të faunës.

- **Subjektet fetare** promovojnë vlerat fetare dhe kulturore të zonës, organizojnë aktivitete fetare dhe maksimizojnë pjesëmarrjen e publikut.

- **Banorët vendës:** pronarët lokalë të tokës, përfitojnë nga turizmi dhe zhvillimi i infrastrukturës, maksimizojnë përfitimet e tyre ekonomike nga aktivitete të ndryshme.

- **Institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e pranishëm në Shqipëri**, përmes projekteve dhe aktiviteteve që lidhen me mbrojtjen e habitateve/specieve, janë UNDP, Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, WWF etj.

4.3 Analiza SWOT

Kjo analizë është e çmuar në theksimin e potencialeve në zonë, duke identifikuar problemet për t'u përmirësuar ose shmangur në menaxhimin e ardhshëm, duke përcaktuar kërcënimet ekologjike dhe social-ekonomike dhe mundësitë e ardhshme për zhvillim.

Pikat e forta	Dobësitë
- Habitata të ndryshme të shpërndara në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit, pyje natyrore dhe të vjetra, kullota, shqopishte dhe shoqërime të bimësisë së ulët; - Faunë e pasur në PK i Malit të Tomorit – grupe kryesore taksonomike të pranishme, prania e llojeve të rralla, endemike; - Galliformet ofrojnë kandidatë të përshtatshëm për ripopullim me qëllim që t'i ruajmë ato. Ekziston një rrezik i ulët i migrimit ose lëvizjes jashtë territorit në krahasim me llojet e tjera të shpendëve; - Rendi i Galliformeve përfshin një popullatë ideale të shpendëve për hulumtime në situata eksperimentale; - Forcimi i sistemit të menaxhimit të ZM-së. Ngritja e Komitetit të Menaxhimit të PK të Malit të Tomorit; - Krijimi i AKZM-së dhe ADZM Berat, të cilët monitorojnë dhe menaxhojnë territorin e PK të Malit të Tomorit; - Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit me zonimin përkatës të territorit; - Partneriteti i fuqishëm për të siguruar përfshirjen e të gjithë aktorëve;	- Prerje intensive të drurëve; - Mungesa e monitorimit dhe sistemit të menaxhimit të zjarreve; - Informacion të kufizuar rreth veçorive të natyrës dhe zonës së mbrojtur; - Praktika të paligjshme dhe të palejuara të gjuetisë; - Ekziston informacion i pakët lidhur me këtë aspekt, sidomos për sa iu përket Galliformeve dhe impaktin e tyre me komunitetin; - Përkrahje e pakët e komunitetit lokal në procesin e ripopullimit të shpendëve në mënyrë që të jetë i suksesshëm; - Mungesa e mbështetjes në nivel lokal mund t'i bëjë aspekte të ndryshme të ripopullimit, shumë të vështira apo të pamundura për t'u realizuar; - Mungesa e eksperteve lokal apo rajonal; - Mungesë koordinimi mes aktorëve kryesorë dhe anëtarëve të Komitetit të Menaxhimit; - Mungesë bashkëpunimi me institucionet lokale;
Mundësitë	Kërcënimet

- Impakte pozitive sociale-ekonomike për komunitetin; - Ekosisteme të mundshme për studime kërkime shkencore për institucionet kërkimore dhe studentët; - Ndërgjegjësim për mbrojtjen e kësaj specie nga komuniteti lokal dhe edukim mjedisor për nxënësit të shkollave; - Ndryshimi i perceptimit që ka komuniteti në lidhje me gjelin e egër; - Ruajtja e specieve individuale; - Reduktimi i humbjeve të biodiversitetit brenda rendit të Galliformeve; - Informacione/trajnime mbi ruajtjen e gjelit të egër; - Pririje të rritjes së mundshme të ekoturizmit; - Rritja e interesit nga turistët ndërkombëtarë dhe lokalë.	- Prerja e paligjshme e drurëve; - Humbje të habitatit dhe fragmentim të tij; - Erozioni; - Modifikime gjeomorfologjike; - Mungesa e eksperteve lokale apo rajonal; - Mungesa e mbështetjes në nivel lokal; - Mungesa e aksesit në strukturën e komunitetit;
--	--

Tabela 4. Analiza SWOT

Pikat e forta – Mundësitë

- Bashkëpunimi me eksperte për hulumtime rreth *Tetrao Urogallus*.
- Aplikimi i të dhënave të përditësuara mbi bioteknologjinë për të optimizuar ruajtjen e *Tetrao Urogallus*.

Pikat e forta – Kërcënime

- Shtimi i numrit të stafit për të monitoruar specien *Tetrao Urogallus*.
- Përcaktimi i rregullave për kushtet e përshtatshme për habitatin e domosdoshëm për *Tetrao Urogallus*.
- Monitorimi i vazhdueshëm i zonës (habitatit) që është e prekshme nga presionet e ndryshme.

Dobësi – Mundësitë

- Shpërndarje informacioni/trajnime rreth ruajtjes së *Tetrao Urogallus*.
- Ngritja e kapaciteteve të stafit të Zonave të Mbrojtura Rajonale Berat, si dhe të ADZM-ve të tjera.

5. Përcaktimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë për ruajtjen e habitateve/specieve në periudha afatshkurtra, të mesme dhe të gjata.

Objektivi kryesor është përballja me humbjen e biodiversitetit, duke përcaktuar strategji të përbashkët për të ruajtur trashëgiminë natyrore dhe peizazhin në zonën e Adriatikut të ulët, me prioritet për speciet e mbrojtura nga direktivat e 92/43/EEC dhe direktiva 79/409/EEC, tipike për këto ekorajone dhe/ose të kërcënuara nga variacionet mjedisore të shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe menaxhimi i gabuar.

Objektivat specifikë janë:

- Ndikim në politikat e mbrojtjes së mjedisit;
- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit përmes qasjeve të integruara dhe aktiviteteve të bashkëpunimit, duke gjeneruar mjete konkrete dhe rezultate që favorizojnë rritjen e qëndrueshme afatgjatë jo vetëm në zonat e përfshira, por edhe në zona të tjera që nuk përfshihen drejtpërdrejt;
- Përmirësimi i nivelit të mbrojtjes së specieve/habitateve të përcaktuara dhe forcimi i bashkëpunimit publik-privat për të nxitur ruajtjen afatgjatë të mjedisit (zbatimi konkret i Strategjisë së Përbashkët Ndërkufitare nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për ruajtjen e habitateve dhe të specieve);
- Vendosja e një ekuilibër të mirë midis zhvillimit social-ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet ndërhyrjeve konkrete dhe rritjes së ndërgjegjësimit me anë të veprimeve sensibilizuese. Projekti do të japë rezultate konkrete dhe mjete që lejojnë përcaktimin e rrugëve të mundshme të zhvillimit, duke përfutur nga shkëmbimi i njohurive.

Më konkretisht, plani i konservimit dhe ripopullimi i Galliformeve ka si qëllim krijimin e një popullatë të lirë dhe të shëndetshme. Kjo gjë do të kontribuonte në ruajtjen e specieve individuale dhe reduktimin e humbjeve të biodiversitetit brenda rendit.

Qëllimi i këtij programi ripopullimi është vendosja e një popullate, e cila do të jetë e shëndetshme në terma afatgjatë, kjo gjë mund të arrihet nëpërmjet dy objektivave:

Objektivi i parë ka të bëjë me mbarështrimin e suksesshëm nëpërmjet rifutjes së individëve dhe pasardhësve të tyre, në mënyrë të tillë që popullatat e rivendosura mund të lidhen me popullatat ekzistuese përreth dhe në këtë mënyrë të shmanget mundësia e incestit. Për të rritur sigurinë e shpendëve të rifutura, në rastin tonë kjo është shumë e vështirë, për shkak të vështirësisë të gjendjes së specieve për ripopullim.

Objektivi i dytë do të ishte lënia e menaxhimit të tyre nga komuniteti, menaxhim i cili nëse do të jetë i përshtatshëm mund të konvertohet në përfitim financiar (p.sh. nëpërmjet turizmit). Kjo është parashikuar në këtë projekt, pra përfshirja e gjithë komunitetit lokal i cili do të ketë rol të rëndësishëm në këtë ripopullim.

Ndërsa qëllimet afatgjata zakonisht përfshijnë ruajtjen e species dhe krijimin e një popullate të pavarur, objektivat afatshkurtër (mbijetesa, riprodhimi) sigurojnë qartësi të menjëhershme mbi suksesin e zhvendosjes dhe shërbejnë si udhëzues për vendimmarrje në të ardhmen.

6. Plan i veprimeve për ruajtjen dhe rikualifikimin e habitatit dhe popullatës (popullatave) së gjelit të egër në Parkun e Tomorit.

Parku Kombëtar i Malit të Tomorit menaxhohet me anë të Planit të Menaxhimit nr. 2027, datë 31.12.2014. Vizioni për Parkun Kombëtar të Tomorit është:

Ruajtja dhe menaxhimi i burimeve të Parkut Kombëtar të Tomorit, vlerës së tyre estetike dhe trashëgimisë kulturore si një vlerë unike dhe universale e bashkëjetesës dhe harmonisë së njeriut me natyrën për brezat e ardhshëm, duke siguruar që Tomori të jetë një vend jetese, edukimi dhe çlodhjeje, si dhe ofrimi efikas i produkteve dhe i shërbimeve turistike të klasës së parë.

Dy nga objektivat afatgjatë të menaxhimit të PK të Malit të Tomorit janë:

1. Rritja e mbrojtjes dhe ruajtjes së habitateve dhe të biodiversitetit;
2. Forcimi i sistemit të menaxhimit të zonës së mbrojtur;

Në lidhje me zonimin e Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit, i cili është një aspekt i rëndësishëm i planit të menaxhimit, duke dhënë një pasqyrë më qartë të menaxhimit të burimeve dhe habitateve të specieve [3], ndahet në:

1. Zona qendrore (ZQ) – 7.484,4 ha;
2. Zona e përdorimit të qëndrueshëm (ZPQ) – 1.365,5 ha;
3. Zona e përdorimit tradicional (ZPT) – 15.640,9 ha;
4. Zona rekreative (ZR) – 232,3 ha.

Plani i veprimeve që do të ndërmerren për mbrojtjen e species *Tetrao Urogallus* dhe të habitateve të përshtatshme janë grupuar si më poshtë:

6.1 Përmirësimin e politikave për ruajtjen e species *Tetrao Urogallus* dhe të planit të menaxhimit

Plani i menaxhimit të PK të Malit të Tomorit duhet të përmirësohet me masa për të siguruar ruajtjen e habitateve kritike të gjelit të egër në malin e Tomorit dhe në zona të tjera të Shqipërisë. Palët përgjegjëse dhe ato të interesuara duhet të sigurojnë zbatimin e tij të plotë. Trajnimi i stafit të ADZM-ve dhe aktoreve të tjerë në terren është i domosdoshëm.

Grupi i punës së kërkimit në terren do të përpiqet të grumbullojë të gjitha të dhënat e mundshme mbi kërcënimet që realisht ekzistojnë në park dhe të planifikojë pastaj masat adekuate që duhen propozuar dhe shpenzimet përkatëse.

Aktivitete:

Vendosja e rojave për të mundësuar një regjim të rreptë kontrolli mbi vendndodhjen e zonës së follenizimit në PK të Malit të Tomorit për periudhën janar–qershor të çdo viti. Nuk duhet të lejohet hyrja e turistëve, vizitorëve brenda zonës gjatë kësaj periudhe.

- Kontroll i shtuar i aksesit të njeriut dhe të banorëve vendës, me qëllim krijimin e një mjedisi të pashqetësuar për gjelin e egër.

- Ndalimi i prerjeve/djegieve në zonat kyçe (territoreve), ku qëndron gjeli i egër.

Prioriteti: Thelbësor

Përgjegjësia: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM); Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ADZM) të Beratit; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MTM).

Palët e tjera të interesuara: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë e Beratit, Skraparit, Gramshit, institucionet lokale, organizatat lokale, institucionet shkencore etj.

Kohëveprimi: I menjëhershëm dhe në vazhdim.

7. Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në habitatet e *Tetrao Urogallus*

Duhet të promovohet një qasje e integruar për ruajtjen e habitateve nga ku do të përfitojë dhe ruajtja e llojeve të tjera. Një qasje e tillë do të mbrojë zonat nga zhvillimi i paqëndrueshëm shoqëruar me ndotje, degradim dhe humbje të habitateve. Njëkohësisht do të rrisë të ardhurat për komunitetet lokale. Përfshirja e tyre në ruajtjen dhe menaxhimin e species dhe të habitateve kritike është e rëndësie së veçantë.

Aktivitete:

Promovimi i konceptit të zonimit, miratuar tashmë përmes Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Mali të Tomorit, ku zonat ku gjeli i egër ka habitatin e tij, të përcaktohen si zona me ruajtje të veçantë.

Promovim i ruajtjes dhe i përfitimit të ndërsjellë me komunitetin lokal të fshatrave Dardhë, Kapinovë e Tomor për rimëkëmbjen e gjelit të egër, aty ku përshtatshmëria e habitateve e lejon atë.

Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendrore të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit.

Ndërtim i një kulle të vëzhgimit të gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit. Ndërtimi i kësaj kulle i shërben promovimit të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vrojtimin e shpendëve.

Prioriteti: Thelbësor

Përgjegjësia: AKZM, ADZM Berati; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MTM)

Palët e tjera të interesuara: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia e Beratit, Skraparit dhe Gramshit, institucionet lokale, organizatat lokale dhe shoqëria civile etj.

Kohëveprimi: I menjëhershëm dhe në vazhdim

8. Forcim i bashkëpunimit ndërkombëtar

Aktivitete:

Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit në vendet fqinje, si Italia dhe Mali i Zi, nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara.

Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të vendeve fqinje në mbrojtje të biodiversitetit, veçanërisht të species gjelit të egër.

Promovim i punës së përbashkët ekipore, hartimin dhe zbatimin e protokolleve të përbashkëta të grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit.

Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e gjelrit të egër për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet.

Përmirësim i bashkëpunimit mes OJF-ve nga Italia dhe Mali i Zi, duke shkëmbyer praktikat më të mira.

Prioriteti: I mesëm

Përgjegjësia: MTM, AKZM; ADZM Berat;

Palët e tjera të interesuara: Ministria Turizmit e Mjedisit, Bashkia e Beratit, Skraparit dhe Gramshit, institucionet lokale, organizatat lokale, institucionet shkencore etj.

Kohëveprimi: I mesëm dhe në vazhdim

8.1. Menaxhimi dhe monitorimi i llojit *Tetrao Urogallos* dhe ruajtjen e habitatit

8.2 Ndërhyrje lidhur me përmirësimin e biotopit

Sikurse është vepruar kudo në botë në rezervatet e gjelrit të egër për mbrojtjen dhe shtyrjen në gjendje normale të popullatës së tij edhe në Parkun e Tomorit duhen planifikuar dhe realizuar gradualisht e për një kohë të gjatë një seri masash (aktivitete), ndër të cilat vend themelor zënë ato që kanë të bëjnë me përmirësimin e habitatit të cilat shkurtimisht janë, si më poshtë:

- Trajtimi i pyjeve, duke pasur parasysh në mënyrë sistematike kërkesat e gjelrit të egër në tërësinë e sipërfaqes së përhapjes së tij e veçanërisht mjediset vitale, siç janë:

- vendet e këngës (arenat);
- vendet e folezimit;
- vendet e rritjes së shpendëve etj.

- Strukturimi i grumbujve pyjorë, siç tregohet në fig. 11, e cila paraqet rastin ideal të një strukture pyjore të favorshme për zhvillimin e natyrshëm të popullatave të këtij shpendi. Realizimi i kësaj strukture do të jetë qëllimi strategjik afatgjatë i trajtimit të pyjeve që do të realizohet gradualisht e për një kohë të gjatë nëpërmjet masave kulturore që do të planifikohen e zbatohen.

- Evitimi i mbylljes së tepëruar e grumbujve pyjorë për një kohë të gjatë, duke favorizuar hapjen e tyre me të gjitha mënyrat e mundshme nëpërmjet përdorimit të metodave të përshtatshme silvikulturore ose nëpërmjet lejimit të një kullote të arsyeshme në pyll.

- Krijimi, kur kjo është e mundur, të një strukture të rregullt e grumbujve pyjorë, duke favorizuar përzierjen e llojeve.

- Mbajtja e një dendësie të tillë e dythundrakëve (kur ata ekzistojnë) që të mos shkaktohet një zhdukje e plotë e nënpyllit dhe e bimësisë barishtore.

- Të ruhet të paktën 30% e sipërfaqes me vegetacion drunor mbi kufirin e epërm të vegetacionit pyjor, e paprekur dhe e padjegur nga punimet e përmirësimit të kullotave, në zonat ku gjendet gjeli i egër duke kursyer pishat gjatë prerjeve kulturore.

8.3 Masa lidhur me menaxhimin e shqetësimeve

- Brenda dhe në periferi të zonave që përdoren për sportin e skive të vendosen nën mbrojtje të plotë zonat e dimërimit të gjelrit të egër gjë që bën që shpendët të mbahen edhe në distancë të afërt nga zona e menaxhuar për këtë qëllim.

- Në të gjitha rastet e krijimit të zonave të reja për qëllime sportive dhe turistike, si dhe kur vendosen sinjalizime të rrugëve apo të rrugicave, gjurmët e vijave (rrugëve) të lëvizjes duhet të respektojnë (evitojnë) zonat e dimërimit të gjelrit të egër.

- Përdorimi i rrugëve pyjore dhe i atyre të lëvizjes së kopeve të kafshëve të buta që shkojnë për kullotë t'u besohet vetëm profesionistëve.

- Transporti me teleferik mund të përbëjë një alternative efikase në krijimin e mundësive të transportit, sepse eviton ndërtimin e rrugëve në habitatet e gjelrit të egër.

8.4 Masa lidhur me gjuetinë dhe problematiken e lindur prej saj

Për momentin gjuetia është një aktivitet që nuk mund të lejohet absolutisht në parkun e Tomorit.

- Nëse mbas një numri vitesh verifikohet që popullatat e gjelit të egër e kanë rimarrë veten (pra do të kenë arritur stadin e një popullate të mbarështruar), si kudo në botën e qytetëruar edhe në parkun e Tomorit, do të bëhej i mundur edhe një shfrytëzim i tyre për qëllime gjuetie. Në këtë rast aplikimi i një “plani gjuetie” do të lejonte të kontrollohej përqindja e vjeljeve (vrasjeve).

- Identifikimi individual i ekzemplareve të vjelë legalisht lejon, gjithashtu, të lehtësohet mënjanimi i brakonazhit dhe trafikut të shpendëve.

- Kuotat e vjeljeve përcaktohen çdo vit në funksion të gjelave që janë prezent në hapjen e gjuetisë dhe të suksesit të riprodhimit.

- Efektiviteti i meshkujve të rritur mund të vlerësohet mbi bazën e numërimit të këngëve të realizuara në maj dhe të përqindjes së tyre të mbijetesës nga pranvera në vjeshtë e cila nga studimet e realizuara në vende të tjera rezulton të jetë 90% .

Planifikimet duhet të bëhen sipas rekomandimeve të mëposhtme:

- Numri i gjelave të vitit vlerësohet në funksion të treguesit të riprodhimit (që është numri i shpendëve të rinj për individë të rritur) të vrojtuar në zonën përkatëse nëpërmjet numërimeve të bëra me anë të “individëve meshkuj kryesor riprodhues” në muajin gusht, duke pasur parasysh një raport të ekuilibruar seksesh (gjinish).

- Efekti i gjuetisë së kontrolluar (vjeljet) do të jenë pa rrezik për stabilitetin e efektivave nëse riprodhimi tejkalon raportin (një shpend të ri: për individë femër të rritur). Konkretisht vjeljet duhet të mos tejkalojnë:

- (5–10) % të efektivit kur riprodhimi është mesatar (1–1,8 shpend të rinj për individ femër);

- (15–20) % të efektivit në rastin e një riprodhimi të mirë (më shumë se 1,8 shpendë të rinj për individ femër);

Kuotave të vjeljeve të përcaktuara në këtë mënyrë duhet t’u zbritet 30% për shkak të mosgjatësisë së shpendëve të vrarë në grumbujt e rinj tepër të dendur.

- Përveç viteve kur riprodhimi dështon, vjeljet duhet të ndërpriten kur tendenca e efektivit tregon një regresion të theksuar ose kur dendësia e shpendëve gjykohej si tepër e ulët.

8.4.1 Masa për përmirësimin e habitatit

Përmirësimi i habitatit realizohet si më poshtë [5]:

- Krijimi me anë të mbjelljeve i disa qindra sipërfaqeve (në formë çeltirash disa hektarësh) me myrtilus të shpërndara në pyje të ndryshme lejon rehabilitimin e mjediseve vitale, në të cilat grumbulli pyjor shumë i dendur nuk lejon bimët që prodhojnë bazën ushqimore të gjelit. Nganjëherë përdoret kullota në pyje si mjet për t’i mbajtur ato të hapura për një kohë të gjatë.

- Aplikimi i rrallimeve të hershme për të evituar pengimin e zhvillimit të vegjetacionit të nënpyllit dhe krijimin e një strukture të çrregullt (me shumë diversitet) në sipërfaqe të mëdha.

- Mbjellja e esencave pyjore të favorshme për gjelin e egër, si: hartine, kerleke, tis, fletore që prodhojnë fruta etj.

Fig. 11. Projektimi i pyjeve për Tetrao Urogallus, kërkesat mjedisore dhe rekomandimet e përgjithshme për implementimin e masave silvikulturale për ruajtjen e Tetrao Urogallus

- Pastrimi në formë mozaiku i sipërfaqeve tepër të mbyllura nga ashja (*rhododendron*), me qëllim që të restaurohet potenciali i tyre tërheqës për individët femra.

- Përcaktimi në pyjet e përhapjes të gjelit të egër të të ashtuquajturave “zona të qëndrimit të species” dhe të “zonave të rritjes së individëve” në sipërfaqe prej disa mijëra hektarësh, të cilat do të krijojnë mundësinë që pjesë të caktuara të pyllit të mbahen në gjendjen e trungishtes së vjetër që korrespondon me optimumin e kërkesave për këtë specie (fig. 11).

8.4.2 Masat që kanë për qëllim të kufizojnë shqetësimet

- Ndalimi për periudha dhe zona të caktuara i “gjuetisë fotografike”, si dhe i qarkullimit rrugor e përdorimit turistik të territorit kur mbrojtja e llojit e kërkon.

- Për zona të rëndësishme me karakter vital për gjelin e egër vendoset ndalimi i çdo ndërhyrjeje njerëzore dhe kalohet në gjetjen dhe eksperimentimin e zgjidhjeve të mundshme.

8.4.3 Masa për kufizimin e mortalitetit aksidental dhe atij artificial

- Hartimi i një programi për identifikimin, kartografimin dhe përdorimi i teknikave zbutëse (spirale plastike të ngjyrosura, vendosja e sferave me ngjyra të forta) për nxjerrjen në pah të kabllove elektrike apo të llojeve të tjera të kabllove, të cilat kalojnë nëpër pyje mbasi ato janë vdekjeprurëse për gjelin e egër.

- Një program i njëjtë hartohet edhe për rrethimet e sipërfaqeve të ndryshme me rrjeta teli për qëllime të ndryshme mbrojtjeje.

- Administrata e zonave të mbrojtura me stafin të ngarkuar për mënjanimin e brakonazhit në çdo pranverë bëjnë mbikëqyrjen brenda ose afër sipërfaqeve të këngës (arenave) për të zbuluar gjuetinë ilegale.

8.4.4 Detaje të tjera të punës për thellimin e njohjes së gjelit të egër në PK i Malit të Tomorit

Për formulimin dhe detajimin e masave të konservimit së popullatave të gjelit të egër është e nevojshme të thellohen njohuritë tona mbi kapacitetet e shpërndarjes së shpendëve të rinj mbas ndarjes së tyre nga bërthama familjare.

Kartografimi i bërthamave më të rëndësishme të popullatave për konservimin e species kërkon të bëhen kërkime të tjera mbi organizimin e këtyre bërthamave në “metapopullata”. Ky kartografim vendoset në raport me njohuritë e përfituara lidhur me kapacitetin e përhapjes së shpendëve të rinj nga bërthamat familjare.

Janë akoma të nevojshme kërkimet për saktësimin e ndikimit të predacionit dhe të shqetësimeve me origjinë antropogjene.

Kërkime suplementare kërkon edhe lidhja që ekziston midis ndryshimeve klimatike dhe suksesit të riprodhimit të gjelit të egër.

- Vlera e gjelit të egër si indikator i diversitetit biologjik të pyjeve të zonave malore duhet të testohet në mënyrë më të thelluar në shkallë të ndryshme madhësie, si pyll, masiv pyjor, njësi natyrale (p.sh. park i niveleve të ndryshme) apo region biogeografik.

- Në një të ardhme më të largët kur popullata dhe habitatet e gjelit të egër të jenë rikualifikuar mund të arrihet deri në promovimin e turizmit nëpërmjet “gjuetisë fotografike” nga observatorë që mund të ngrihen në afërsi të “arenave”, fig. 10, si dhe planifikimi i një vjeljeje vjetore të kontrolluar e cila mund të jetë objekt i një “gjuetie turistike”.

- Përveç këtyre, duke e ditur rëndësinë gjithnjë e më të qartë të këtij shpendi të egër si indikator i diversitetit biologjik pyjor, si dhe zhvillimin në rritje të koncepteve të “zhvillimit të qëndrueshëm” apo të “zhvillimit multifunksional”, marrja parasysh e tij në menaxhimin e hapësirave pyjore malore mund të konsiderohet si një nga mjetet nëpërmjet të cilave mund të arrihen këta objektiva.

Për të gjitha problemet që mund të hasen gjatë zbatimit të planit, studiuesit në terren verifikojnë problematikën që ekziston, urgjencën e zgjidhjes së saj, duke parashikuar pastaj masat që duhen marrë, duke planifikuar realizimin e tyre dhe shpenzimet përkatëse.

Prioriteti: Thelbësor

Përgjegjësia: AKZM, ADZM Berat, shoqata mjedisore.

Palët e interesuara: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të territorit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, institucionet lokale, shoqatat lokale, shoqatat e gjuetarëve, institucionet shkencore etj.

Kohëveprimi: I menjëhershëm dhe në vijim

8.4.5 Shtirja në kohë e aktiviteteve konservuese

Aktivitetet për ruajtjen e llojit shtrihen gjatë gjithë kohës së zbatimit të planit, pra në periudhën kohore 2-vjeçare. Por, aktivitetet të cilësuar si thelbësore dhe me efekt të menjëhershëm janë parashikuar të zbatohen që në vitin e parë të planit. Ndërkaq, aktivitetet e tjera do të zbatohen në vitin e dytë (tabela 5).

Nr.	Aktivitetet	Periudha
9.1	Përmirësimin e politikave për ruajtjen e species gjeli i egër dhe të planit të menaxhimit	
a)	Vendosja e rojave për të mundësuar një regjim të rreptë kontrolli mbi vendndodhjen e zonës së folezimit në PK të Malit të Tomorit për periudhën janar–qershor të çdo viti. Nuk duhet të lejohet hyrja e turistëve, vizitorëve brenda zone gjatë kësaj periudhe.	Gjatë gjithë zbatimit
b)	Kontroll i shtuar i aksesit të njeriut dhe banorëve vendës, me qëllim krijimin e një mjedisi të pashqetësuar për gjelin e egër.	Gjatë gjithë zbatimit
c)	Ndalimi i prerjeve/djegjeve në zonat kyçe (territoreve) ku qëndron gjeli i egër.	Gjatë gjithë

		zbatimit
9.2	Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në habitatet e gjelit të egër	
a)	Promovimi i konceptit të zonimit, miratuar tashmë përmes Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit, ku zonat ku gjeli i egër i ka habitat të tij, të përcaktohen si zona me ruajtje të veçantë	Gjatë gjithë zbatimit
b)	Promovim i ruajtjes dhe i përfitimit të ndërsjellë me komunitetin lokal të fshatrave Dardhë, Kapinovë, Tomor e Ujanik, për rimëkëmbjen e gjelit të Egër aty ku përshtatshmëria e habitateve e lejon atë	Gjatë gjithë zbatimit
c)	Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendrore të Parkut Kombëtar Malit të Tomorit	Gjatë gjithë zbatimit
d)	Ndërtim i një kulle të vëzhgimit të gjelit të egër në Parkun Kombëtar Malit të Tomorit. Ndërtimi i tyre i shërben promovimit të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vrojtimin e shpendëve	Viti i dytë
9.3	Forcim i bashkëpunimit ndërkombëtar	
a)	Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit në vendet fqinje, si Italia dhe Mali i Zi, nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara	Gjatë gjithë zbatimit
b)	Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të vendeve fqinje në mbrojtje të biodiversitetit, veçanërisht të species gjelit të egër	Gjatë gjithë zbatimit
c)	Promovim i punës së përbashkët ekipore, hartimin dhe zbatimin e protokolleve të përbashkët të grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit	Gjatë gjithë zbatimit
d)	Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e gjelit të egër për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet	Gjatë gjithë zbatimit
e)	Përmirësim i bashkëpunimit mes OJF-ve nga Italia dhe Mali i Zi, duke shkëmbyer praktikat me të mira.	Viti i parë
9.4	Menaxhimi dhe monitorimi i llojit <i>Tetrao Urogallus</i> dhe ruajtjen e habitatit	
9.4.1	Ndërhyrje lidhur me përmirësimin e biotopit	Viti i parë
9.4.2	Masa lidhur me menaxhimin e shqetësimeve	Gjatë gjithë zbatimit
9.4.3	Masa lidhur me gjuetinë dhe problematiken e lindur prej saj	
9.4.4	Masa për përmirësimin e habitatit	Gjatë gjithë zbatimit
9.4.5	Masat që kanë për qëllim të kufizojnë shqetësimet	Gjatë gjithë zbatimit
9.4.6	Masa për kufizimin e mortalitetit aksidental dhe atij artificial	Gjatë gjithë zbatimit
9.4.7	Detaje të tjera të punës për thellimin e njohjes së gjelit të egër në PK Malit të Tomorit	Gjatë gjithë zbatimit

Tabela 5. Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese

9. Informacione dhe masa sensibilizuese për aktorët dhe për popullsinë lokale në drejtim të thellimit të njohjes së gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

Edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor i ndërmarrë në 20 vitet e fundit duket se po jep frytet e veta por ka ende nevojë që ruajtja e biodiversitetit dhe specieve në rrezik, si gjeli i egër të rrënjohet jo vetëm në komunitetin vendor, por edhe atë kombëtar. Për këtë nevojitet trajnim i mëtejshëm i stafit të ADZM-së përgjegjëse, administratës vendore dhe grupeve të tjera të interesit.

Aktivitete:

Organizmi i fushatave ndërgjegjëse publike me gjuetarët, komunitetet lokale, operatorët turistikë, institucionet qeveritare që janë pjesë e mbrojtjes së species gjelit të egër.

Organizim i vizitave shkëmbyese në vende partnere për të njohur dhe ndarë praktikat më të mira të ruajtjes së gjelit të egër dhe menaxhimit të habitateve të tij.

Përgatitja e publikimeve si (fletëpalosje, broshura, postera etj.) mbi rëndësinë e habitatit/species në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Trajnim i stafit të ADZM-ve, në lidhje me edukimin mjedisor, ruajtjen dhe menaxhimin e shpendëve, jetës së egër në përgjithësi.

Trajnim i OJF-ve dhe i grupeve të tjera të interesit për ruajtjen e natyrës, duke u përqendruar veçanërisht në ruajtjen e gjelit të egër.

Trajnim i guidave ekoturistike për të shoqëruar turistët që vizitojnë Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit

Zhvillimi i një moduli trajnimi për stafin ADZM-së përgjegjëse për zbatimin e ligjit mbi rregullat dhe rregulloret që lidhen me mbrojtjen e gjelit të egër.

Rritja e kapaciteteve teknike të punonjësve të zonave të mbrojtura, mbi:

- monitorimin e shpendëve;
- pajisjet e menaxhimit të cilat janë të rëndësishme për ruajtjen e gjelit të egër;
- minimizimin e ndërhyrjeve nga njerëzit dhe shqetësimeve të tjera të veçanta.

10. Vlerësim i impaktit të Planit të Veprimit për mbrojtjen dhe menaxhimin korrekt të habitatit/species

10.1 Problemet e pritshme gjatë implementimit

Zbatimi i planit mund të hasi në vështirësi, për shkak të faktorëve të ndryshëm të jashtëm, të cilët mund të ndikojnë në suksesin e tij. Është e nevojshme që këto faktorë të identifikohen dhe të listohen paraprakisht në mënyrë që të kontrollohen në mënyrë sa më efektive.

Katastrofa ekologjike natyrore: mund të përmendim kushtet e ashpra të motit (zjarre, dëmtime të bimësisë etj.) dhe epidemitë.

10.2 Impakti njerëzor

Është tashmë e njohur që faktori njerëzor i shprehur si shqetësim njerëzor ka një influencë të lartë në popullatat e shpendëve në Shqipëri. Ky është një alarm për të qenë shumë të kujdesshëm me kontrollin e gjuetisë në PK e Malit të Tomorit, në mënyrë që të mos cenohet popullata e gjelit të egër.

Ndryshimi i habitatit ose dëmtimi i tij nga aktivitete të ndryshme të banorëve vendës (prerje e pemëve, kositje e celtinave etj.) kanë një impakt të drejtpërdrejtë, sepse ato dëmtojnë habitatet jetike për llojin. Ato sjellin shqetësime të ndryshme, të cilat kanë efekte afatgjata në popullatë dhe ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe suksesin e zhvillimit pozitiv të saj.

Aktivitetet turistike të pakontrolluara, sidomos në zona me rëndësi të veçantë për llojin mund të sjellin shqetësim të vazhdueshëm të popullatës së tij edhe ulje të suksesit të riprodhimit të llojit.

Mënyra e vetme në terma afatshkurtër për të parandaluar impaktin negativ është kontrolli i këtyre aktiviteteve nga rangersat lokalë. Ruajtja e tij në mënyrë më afatgjatë mund të arrihet nëpërmjet ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë që ka gjeli i egër si aset i çmuar natyror i zonës së PK i Malit të Tomorit, i cili ndikon në zhvillimin ekoturistik dhe ekonomik të popullsisë lokale.

Me qëllim që të sigurohemi që ruajtja dhe shtimi është planifikuar siç duhet, do të merren në konsideratë çështjet e mëposhtme:

- ruajtja e territorit natyror, e cila mbart habitate të përshtatshme për gjelin e egër;
- eliminimi i faktorëve, që shkaktuan zhdukjen e pjesshme të popullatës dhe identifikimi i rreziqeve të tjera potenciale;
- krijimi i kushteve për një rikolonizim natyral;
- sigurimi i kushteve për një zhvillim dhe qëndrueshmëri afatgjatë të popullatës, në mënyrë që të arrihet një popullatë e shëndetshme gjenetikut;
- ndërgjegjësimi i popullatës vendëse për rëndësinë që ka lloji në zhvillimin e ekoturizmit në zonë.

11. Identifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare, të cilat do të përfshihen në projekt nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet publike dhe private

Partneriteti do të sigurojë ekspertizën e nevojshme teorike dhe teknike për zhvillimin optimal të projektit. Partnerët kryesorë do jenë autoritetet lokale, stafi i ADZM Berat, të cilët do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e tij në terren. Gjithashtu OJF-të rajonale, institutet kërkimore, dhe universitetet do jenë partnerë të rëndësishëm, të cilët do të japin kontributin e tyre në ndërgjegjësimin e popullatës vendëse për rëndësinë e gjelit të egër dhe duke ndarë informacione shkencore. Pasi planet e punës të miratohen, ato do të përfaqësojnë një mjet me anë të të cilit çdo grup interesi do zhvillojë aktivitete konkrete, me synim ruajtjen e gjelit të egër. Çdo partner do të kontribuojë duke siguruar të dhëna, duke identifikuar problemet dhe duke sugjeruar zgjidhjet e mundshme respektivisht sipas fushës përkatëse. Banorët vendës, gjithashtu, do të jenë bashkëpunëtorë të rëndësishëm, duke qenë se ata janë në kontakt të vazhdueshëm me zonën dhe luajnë një rol kyç në ruajtjen e balancave të shfrytëzimit të mjedisit në zonën me interes dhe rrjedhimisht dhe impaktin mbi llojin *Tetrao Urogallus*.

Dhënia e fondeve për implementimin e planit është planifikuar të zhvillohet nga dy burime, si më poshtë:

Burime të brendshme:

- buxheti i shtetit të Republikës së Shqipërisë nga pjesa e përcaktuar për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- burimet e institucioneve shkencore dhe akademike;
- burimet e Shoqatës Shqiptare të Gjuetisë;
- burime të tjera (p.sh. sektori i biznesit)

Burime të huaja:

- Komuniteti Evropian – përmes programeve IPA CBC Itali–Shqipëri–Mali i Zi për disa vjet dhe për projekte të caktuara;
- kontribute të huaja;
- burime të tjera.

12. Monitorimi i Planit të Veprimit për kontrollin e efektivitetit të veprimeve

Monitorimi i Planit të Veprimit

Çdo plan konservimi ka nevojë për monitorim të thellë në mënyrë që sukcesi i Planit të Veprimit të bëhet i matshëm. Monitorimi duhet të fokusohet në përmbushjen e qëllimeve të Planit të Veprimit.

Në rastin tonë monitorimi duhet:

- të kontrollojë suksesin e riprodhimit të popullatës së gjelit të egër;
- të kontrollojë madhësinë e popullatës së gjelit të egër;
- të kontrollojë nivelin e ndërgjegjësimit publik nëpërmjet intervistave me përfaqësues ose jo të zonës;
- të kontrollojë numrin e publikimeve kërkimore që përmendin gjelin e egër.

13. Lista e indikatorëve për monitorimin

Aktivitetet	Indikatorët	0 = nuk ka filluar; 1 = në proces; 2 = i përfunduar			
		Realizimi			Vlerësime/korrigjime shënime
		0	1	2	
Përmirësimin e politikave për ruajtjen e species gjeli i egër dhe të	Vendosja e rojave për të mundësuar një regjim të rreptë kontrolli mbi vendndodhjen e zonës së folelizimit në PK të Malit të Tomorit për periudhën janar–qershor të çdo viti. Nuk duhet të lejohet hyrja e turistëve, vizitorëve brenda zonës gjatë kësaj periudhe				

Planit të menaxhimit	Kontroll i shtuar i aksesit të njeriut dhe të banorëve vendës, me qëllim krijimin e një mjedisi të pashqetësuar për gjelin e egër				
	Ndalimi i prerjeve/djegjeve në zonat kyçe (territoreve) ku qëndron gjeli i egër				
Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në habitatet e gjelit të egër	Promovimi i konceptit të zonimit, miratuar tashmë përmes Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit, ku zonat ku gjeli i egër i ka habitat të tij, të përcaktohen si zona me ruajtje të veçantë				
	Promovim i ruajtjes dhe i përfitimit të ndërsjellë me komunitetin lokal të fshatrave Dardhë, Kapinovë, Tomor e Ujanik, për rimëkëmbjen e gjelit të egër aty ku përshtatshmëria e habitateve e lejon atë				
	Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendrore të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit				
	Ndërtim i një kulle të vëzhgimit të gjelit të egër në Parkun Kombëtar të Malit të Tomorit. Ndërtimi i tyre i shërben promovimit të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vrojtimin e shpendëve				
Forcim i bashkëpunimit ndërkombëtar	Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit në vendet fqinje, si Italia dhe Mali i Zi nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara.				
	Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të vendeve fqinje në mbrojtje të biodiversitetit, veçanërisht të species gjelit të egër				
	Promovim i punës së përbashkët ekipore, hartimin dhe zbatimin e protokolleve të përbashkët të grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit				
	Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e gjelit të egër për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet				
	Përmirësim i bashkëpunimit mes OJF-ve nga Italia dhe Mali i Zi, duke shkëmbyer praktikatat me të mira				
Menaxhimi dhe monitorimi i llojit <i>Tetrao Urogallus</i> dhe ruajtjen e habitatit	Ndërrhyrje lidhur me përmirësimin e biotopit				
	Masa lidhur me menaxhimin e shqetësimeve				
	Masa lidhur me gjuetinë dhe problematikën e lindur prej saj				
	Masa për përmirësimin e habitatit				
	Masat që kanë për qëllim të kufizojnë shqetësimet				
	Masa për kufizimin e mortalitetit aksidental dhe të atij artificial				
	Detaje të tjera të punës për thellimin e njohjes së gjelit të egër në PK të Malit të Tomorit				